# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5412
E mërkurë, 28 shkurt 2018
çmimi 0.40 €



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"


## Limaj: Vendimi për themelimin e Nismës doli se ishte i drejtë

FAQE 6




Me rastin e katërvejtorit të themelimit të Nismës Socialdemokrate, lideri i saj, Fatmir Limaj, ka thënë se kjo forcë politike i duhet Kosovës. Ai ka thënë se Nisma ka për synim mbrojtjen e qytetarit të saj dhe dallon prej partive të tjera


AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", MEMLI KRASNIQI FAQE 4-5

# Jemi optimistë se do të kalojë demarkacioni



Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, beson se votat e nevojshme për kalimin e demarkacionit do të sigurohen në çastin e fundit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", se deputetët të cilët kanë konfirmuar mbështetjen për këtë marrëveshje nuk e kalon numrin 78, ai ka shprehur optimizëm se në momentin e votimit Projektligji për demarkacionin do të përkrahet edhe nga ndonjë deputet i Lëvizjes Vetëvendosje apo i Listës Serbe. Sipas Krasniqit, disa deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje nuk kanë mendim refuzues për demarkacionin. Sa i përket Listës Serbe, ai ka thënë se ky subjekt politik nuk ka ende qëndrim përfundimtar nëse do ta votojë apo jo demarkacionin

SOT (E MËRKURË) DO TË MBAHET SEANCA E JASHTËZAKONSHME E KUVENDIT TË KOSOVËS PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR SHËNIMIN E KUFIRIT ME MALIN E ZI

FAQE 8-9

## Porosia e BE-së dhe e ShBA-së: Çasti i fundit për ta votuar demarkacionin

Shefja e Zyrës e Bashkimit Evropian në Kosovë, Natalya Apostolova dhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Greg Delawie, u kanë bërë thirrje të martën edhe një herë deputetëve ta ratifikojnë marrëveshjen për shënimin e kufirit me Malin e Zi. Ata kanë bërë me dije se është çasti i fundit të miratohet demarkacioni, në mënyrë që Kosova t'i zë afatet e nevojshme për heqjen e vizave brenda vitit





## Në mars vazhdon dialogu edhe ndërmjet presidentëve

Zëdhënësja e shefes së BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Maja Kocijançiq, ka bërë me dije se dialogu teknik në mes të Kosovës dhe Serbisë do të vazhdojë në muajin e ardhshëm, ku do të diskutohet sërish për zbatimin e marrëveshjeve të arritura më herët në Bruksel. Ajo ka theksuar se gjatë muajit mars pritet të mbahet edhe takimi i nivelit politik ndërmjet presidentëve të dy vendeve

FAQE 7

## AKTUALE

REFUZIMI I FRUSTRUAR I DEKORATAVE TË LIRISË F. 12



Sali BISLIMI

KOSOVA VENDOS MARRËDHËNIE DIPLOMATIKE ME BANGLADESHIN F. 6

EKSPERTËT KROATË DO TA NDIHMOJNË SHËNDETËSINË E KOSOVËS F. 7

## EKONOMI

METALET, SHTYLLA KRYESORE E EKSPORTIT TË KOSOVËS F. 9

THEMELOHET ORGANI I PËRHERSHËM PËR PARATË VIRTUALE F. 9

## KULTURË

BASHKIMI SI SYNIM INICIAL I JETËS DHE I VEPRIMTARISË SË DEMAÇIT F. 13

Prof. dr. Shyqri GALICA

## SPORT

KRASNIQI: NDAJ PRISHTINËS E DUAM FITOREN E TITULLIT F. 16

SOT FILLON 'FINAL 8', PREMTOHET SPEKTAKËL BASKETBOLLI F. 16


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Të martën në Beograd është mbajtur takimi trepalësh Shqipëri - Itali - Serbi

# Bushati: Dialogu, instrumenti i duhur për zgjidhje të përbashkëta

Lidhur me procesin e normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, Bushati theksoi se dialogu është investimi më i mirë që ofron mundësi reale drejt pajtimit përfundimtar dhe rrugës së përbashkët evropiane



BEOGRAD, 27 SHKURT - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati, mori pjesë në takimin e tretë të ministrave të jashtëm, atij të Shqipërisë, të Italisë dhe të Serbisë që u mbajt në Beograd, nën përkujdesjen e zëvendëskryeministrit të parë dhe ministrit të Punëve të Jashtme, Ivica Daçiq.
Gjatë diskutimeve në takim, ministrat morën në shqyrtim arritjet e kësaj nisme dhe bashkëbiseduan mbi drejtimet e ardhshme të punës në kontekstin e dinamikës së evropianizimit të rajonit tonë. Diskutimet u përqendruan në qasjen e përbashkët të vendeve të rajonit dhe bazuar mbi avokatinë e Italisë për një rigjallërim të politikës së zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor dhe Strategjinë e publikuar së fundmi nga Komisioni Evropian, si një dokument që e vë theksin në jetësimin e ëndrrës integruese të rajonit.
Gjithashtu, ministrat u pajtuan ta shtrijnë veprimin e Trilateralit edhe në nivel sektorial, përmes një kalendari periodik takimesh të institucioneve dhe agjencive të linjës.
Gjatë qëndrimit të tij në Beograd, Bushati zhvilloi një takim me zëvendëskryeministrin e parë dhe ministrin e Punëve të Jashtme të Republikës së Serbisë, Ivica Daçiq.
Lidhur me procesin e normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, Bushati theksoi mbështetjen e vendosur të Shqipërisë për dialogun me ndërmjetësimin e BE-së, si instrumenti i duhur për të arritur drejt zgjidhjeve të përbashkëta për një sërë çështjesh të rëndësishme në dobi të jetës së qytetarëve të dy vendeve. "Ky është investimi më i mirë që ofron mundësi reale drejt pajtimit përfundimtar dhe rrugës së përbashkët evropiane", theksoi ministri Bushati.
Më tej, ai kërkoi nga pala serbe vullnet real dhe angazhim të vendosur politik për çështje që përfshijnë kufizimet dhe pengesat për tregun e energjisë, gjithëpërfshirjen dhe anëtarësimin në organizatat rajonale e ndërkombëtare. Ministri Bushati nënvizoi interesin e posaçëm të qeverisë për shqiptarët e Luginës së Preshevës, duke kërkuar më shumë kujdes e vëmendje dhe përfshirje më të madhe në jetën socio-ekonomike të Serbisë, si dhe garantimin e të drejtave tërësore.

# Merkeli i kërkon Serbisë marrëveshje me Kosovën



BERLIN, 27 SHKURT - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili është takuar të martën me kancelaren gjermane Angela Merkel, ka thënë se shteti serb është i gatshëm për një zgjidhje me Kosovën nëse të dyja palët humbin diçka. "Nuk i fsheha nga Merkeli problemet me të cilat ballafaqohemi. Ne do të punojmë. Serbia është gati për një zgjidhje me anë të së cilës të dyja palët humbin diçka. Serbia nuk mund të jetë e vetmja humbëse", ka thënë Vuçiqi në një konferencë të përbashkët me Merkelin.
Ai ka shtuar se Gjermania nuk e mbështet Serbinë vetëm ekonomikisht, por edhe politikisht është një nga vendet më të rëndësishme. "Ne e dimë se përpara nesh është një kohë e vështirë për t'u marrë me kapitujt 23 dhe 24, e vështirë të zgjidhet është edhe çështja e Kosovës", ka thënë Vuçiqi.
Ndërsa kancelarja gjermane Angela Merkel ka thënë se Gjermania e mbështet rrugën e Serbisë drejt BE-së. "Negociatat e anëtarësimit mund të jenë të suksesshme nëse reformat vazhdojnë të ndryshojnë në fushën e sundimit të ligjit dhe normalizohen marrëdhëniet me Kosovën. Duhet të ketë zgjidhje kontraktuale me Kosovën", ka thënë Merkeli.

LAJME SHKURT

## Berisha: Si mashtroi Bushati për negociatat me Greqinë

TIRANË, 27 SHKURT - Ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, ka vazhduar denoncimin ndaj negociatorit të Ministrisë së Jashtme, Artur Muçollari. Duke publikuar disa mesazhe, që Berisha thotë se ia kanë dërguar disa qytetarë, ai shprehet se Muçollari nuk duhet të jetë pjesë e negociatave me Greqinë, pasi ai është larguar nga ushtria disa vite më parë, si informatori i shërbimeve të huaja inteligjente. Po ashtu, duke sjellë në vëmendje një foto të bërë gjatë takimit të ministrit të Jashtëm Ditmir Bushatit dhe homologun grek Kotzias në Korçë, ku ishte edhe Muçollari, Berisha thotë se kjo hedh poshtë pretendimin e Qeverisë se ka pasur vetëm negociata politike dhe teknike.

## Xhafaj: Vettingu, një faqe e re për historinë e policisë

TIRANË, 27 SHKURT - Kuvendi i Shqipërisë miratoi në parim Projektligjin për Vettingun në radhët e Policisë së Shtetit, ndërsa ministri Xhafaj ka reaguar në "Twitter", duke falënderuar të gjithë ata që dhanë kontributin e tyre për këtë ligj. Xhafaj shkruan se një tjetër faqe e re po hapet në reformimin e policisë. "Vettingu do ta ndryshojë rrënjësisht atë. Histori e një policie moderne evropiane do të jetë ajo pas Vettingut", tha ai. "Ligji i Vettingut mori dritën jeshile nga Kuvendi. Faleminderit të gjithë atyre që e mbështetën e punuan për këtë nismë! Faleminderit kolegëve socialistë për votën e qartë pro këtij projekti! Faleminderit për ata kolegë të opozitës që kontribuuan në këtë proces duke e mirëkuptuar votën politike të tyre!", ka thënë Xhafaj. Ai ka shprehur vlerësim dhe mirënjohje për bashkëpunëtorët e tij që punuan për këtë projekt shumë të rëndësishëm, për partnerët vendës dhe ata ndërkombëtarë.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Sot (e mërkurë) do të mbahet seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës për ratifikimin e marrëveshjes për shënimin e kufirit me Malin e Zi

# Porosia e BE-së dhe e ShBA-së: Çasti i fundit për ta votuar demarkacionin

Shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Natalya Apostolova dhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Greg Delawie, u kanë bërë thirrje të martën edhe një herë deputetëve ta ratifikojnë marrëveshjen për shënimin e kufirit me Malin e Zi. Ata kanë bërë me dije se është çasti i fundit të miratohet demarkacioni, në mënyrë që Kosova t'i zë afatet e nevojshme për heqjen e vizave brenda vitit



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 27 SHKURT - Sot (e mërkurë) në orën 10:00 do të mbahet seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës, në të cilën është paraparë të ratifikohet Marrëveshja për Shënimin e Kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi. Një ditë para mbajtjes së kësaj seance, përfaqësuesja e Bashkimit Evropian në Kosovë, Natalya Apostolova dhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Greg Delawie, u kanë bërë sërish thirrje deputetëve ta votojnë demarkacionin me Malin e Zi. Gjatë takimeve të ndara me kryeparlamentarin Kadri Veseli, ata kanë thënë se është çasti i fundit të miratohet demarkacioni, në mënyrë që Kosova t'i zë afatet e nevojshme për heqjen e vizave brenda këtij viti.

Shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Natalya Apostolova, në një konferencë të përbashkët për medie me kryeparlamentarin Kadri Veseli, ka thënë se Kosova është afër zgjidhjes së çështjes së demarkacionit. Sipas saj, nënshkrimi i deklaratës nga presidentët Thaçi - Vujanoviq si dhe arritja e marrëveshjes në mes të partive në pushtet dhe LDK-së janë dy hapa të rëndësishëm në këtë drejtim. "Ditët e fundit kemi pasur dy hapa shumë të rëndësishëm drejt përparimit për çështjen e demarkacionit të Kosovës me Malin e Zi. Hapi i parë ka qenë deklarata e nënshkruar në mes të dy presidentëve, atij të Malit të Zi dhe atij të Kosovës, të cilën e kemi vlerësuar shumë. Hapi i dytë është marrëveshja pothuajse në mes të gjitha partive politike, PDK-së, AAK-së, Nismës, 6+ dhe LDK-së. Të gjitha këto parti e mbështesin votimin e demarkacionit. Jemi afër që ta zgjidhim këtë çështje, prandaj është shumë e rëndësishme që miratimi i demarkacionit të ndodhë të mërkurën. Kjo duhet të bëhet. Ratifikimi do të jetë një hap i rëndësishëm në rrugën drejt liberalizimit të vizave për Kosovën. Po ashtu, Kosova ende duhet ta vazhdojë luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar", është shprehur Apostolova, duke u bërë thirrjet deputetëve të mendojnë për të ardhmen e Kosovës dhe të qytetarëve. "Deputetët duhet të mendojnë për qytetarët e Kosovës dhe për të ardhmen e Kosovës në Bashkimin Evropian. Liberalizimi i vizave u hap mundësi studentëve, bizneseve, krijimit të vendeve të reja të punës dhe zhvillimit ekonomik. Pra, dëshirojmë që me liberalizimin e vizave të arrijmë që Kosova të jetë një vend më i mirë për qytetarët e saj. Të gjitha partitë politike në Kuvend nuk duhet ta humbin këtë rast për ta miratuar demarkacionin. Ju lutem na ndihmoni neve, në mënyrë që edhe ne t'ju ndihmojmë juve", ka deklaruar Apostolova.



Kurse kryeparlamentari Kadri Veseli ka pohuar se populli i Kosovës në histori ka humbur shumë raste dhe nuk do të lejojë të humbë raste të reja. Ai ka kërkuar nga i gjithë spektri politik që të jetë bashkë në forcimin e sovranitetit dhe ecjen e vendit përpara. Veseli ka shprehur optimizëm se demarkacioni me Malin e Zi do të miratohet sot (e mërkurë). "Besoj edhe në reflektimin e kolegëve që ende nuk e kanë marrë këtë vendim. Jemi para një dite që do t'i hapë perspektivë Kosovës. Liberalizimi duhet të ndodhë dhe ratifikimi i marrëveshjes do të votohet. Kosova dhe qytetarët e saj kanë nevojë për një lajm të mirë dhe ne do ta sjellim këtë lajm të mërkurën. Ratifikimi jep sinjal të qartë për perspektivën drejt BE-së dhe presim nga BE-ja të na ndihmojë në rrugëtimin tonë integrues", ka theksuar Veseli.

Po të martën kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur në takim edhe ambasadorin e ShBA-së në Prishtinë, Greg Delawie, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet e fundit politike në vend, me theks të veçantë për seancën e jashtëzakonshme ku pritet të ratifikohet marrëveshja për shënimin e kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi. Me këtë rast, Veseli ka shprehur optimizëm se kjo marrëveshje do të miratohet. Veseli dhe Delawie janë pajtuar se është çasti i fundit që Kosova ta ratifikojë këtë marrëveshje, për t'i zënë afatet e nevojshme për heqjen e vizave gjatë këtij viti. Gjithashtu, ambasadori Delawie ka rikonfirmuar mbështetjen e ShBA-së për Republikën e Kosovës në të gjitha fushat.

# Kurti: Tokën nuk e japim

Ndërsa lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka kundërshtuar sërish marrëveshjen për demarkacionit me Malin e Zi. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se 8 200 hektarët që po diskutohen për këtë marrëveshje kanë qenë çdoherë të Kosovës. Sipas tij, këtë pjesë pushtetarët e Kosovës po duan ta japin për ta garantuar vazhdimin e pushtetit. "8 200 hektarët nuk janë as tokë e Rusisë, as e BE-së. 8 200 hektarët janë në skajin perëndimor të Kosovës së orientuar kah Perëndimi, te BE-ja dhe NATO-ja. 8 200 hektarët nuk janë kurrfarë udhëkryqi gjeopolitik lindje-perëndim. 8 200 hektarët nuk janë as çiflig e pronë e pushtetarëve të korruptuar që duan ta japin si ryshfet për ta garantuar vazhdimin e pushtetit. Ajo tokë ka qenë gjithnjë e Kosovës, e shqiptarëve. Kjo është dëshmuar gjerësisht me dokumentacion vendor e ndërkombëtar. Serbë dhe malazezë aty nuk ka pasur kurrë, përveçse me uniformë, por edhe ata janë shporrur", ka theksuar Kurti. Ai ka kritikuar edhe bashkësinë ndërkombëtare që po e lejon një sjellje të tillë të politikanëve të Kosovës. "Qytetarët e Kosovës e meritojnë të drejtën për të udhëtuar lirshëm, pa viza, pa pasur pse ta durojnë këtë dhunë e poshtërsi. Tokën nuk e japim. Ne nuk kemi hesap të vazhdojmë me këta pushtetarë", është shprehur Kurti.

# Shoqata 'Miqtë e Amerikës' nderon 'Epokën e re'

PRISHTINË, 27 SHKURT - Me rastin e 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës dhe 14-vjetorit të themelimit të Shoqatës "Miqtë e Amerikës", kryetari i kësaj shoqate, Agim Rexhepi, sot ka vizituar redaksinë e gazetës "Epoka e re", me ç'rast ka nderuar, me emblemën e ish-presidentit amerikan Bill Clinton, gazetën "Epoka e re" dhe botuesin e saj Muhamet Mavraj, për kontributin e dhënë në fushën e medias. Mirënjohjen në emrin e gazetës "Epoka e re" e ka pranuar kryeredaktori i gazetës "Epoka e re", Mal Qorraj.



Rexhepi ka falënderuar stafin e gazetës për mbështetjen dhe përcjelljen e aktiviteteve për 14 vjet që nga themelimi i kësaj shoqate. Stafi i gazetës "Epoka e re" ka përgëzuar kryetarin e Shoqatës "Miqtë e Amerikës", Agim Rexhepi, dhe gjithë anëtarësinë e kësaj shoqate për punën e palodhshme në kujtim të burrështetasit të madh të Amerikës, Bill Clinton.

Flet për "Epokën e re", Memli Krasniqi

# Jemi optimistë se do të



Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, beson se votat e nevojshme për kalimin e demarkacionit do të sigurohen në çastin e fundit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", se numri i deputetëve të cilët kanë konfirmuar mbështetjen për këtë marrëveshje nuk e kalon numrin 78, ai ka shprehur optimizëm se në momentin e votimit Projektligji për demarkacionin do të përkrahet edhe nga ndonjë deputet i Lëvizjes Vetëvendosje apo Listës Serbe. Sipas Krasniqit, disa deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje nuk kanë mendim refuzues për demarkacionin. Sa i përket Listës Serbe, ai ka thënë se ky subjekt politik nuk ka ende qëndrim përfundimtar nëse do ta votojë apo jo demarkacionin

EPOKA E RE Muhamet KOCI

**Prishtinë, 27 shkurt** - Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka shprehur optimizëm se votat për ratifikimin e demarkacionit me Malin e Zi do të sigurohen në çastin e hedhjes së projektligjit në votim. Ndonëse ka pranuar se tani për tani nuk janë votat e mjaftueshme për kalimin e kësaj marrëveshje, Krasniqi beson se dikush prej deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje ose të Listës Serbe do ta votojë këtë marrëveshje. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka ftuar deputetët e këtyre subjekteve politike të votojnë ndryshe prej qëndrimeve partiake. "Ne shpresojmë që në momentin e fundit kur do të votohet projektligji do të kemi më shumë se 80 vota, qofshin ato nga deputetët e Listës Serbe apo të Lëvizjes Vetëvendosje", ka thënë Krasniqi.

Ai ka bërë me dije se deri më tani disa deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje kanë shprehur një qëndrim ndryshe nga ai i lidershipit partiak për çështjen e demarkacionit. "Evidente është se tashmë dihet se ka deputetë brenda grupit të Vetëvendosjes, të cilët nuk e ndajnë mendimin refuzues për demarkacionin të paraqitur nga krerët e kësaj partie. Kjo varet nëse do të kenë ata kurajë për të votuar në interes të qytetarëve të Kosovës dhe jo në interes të lidershpit partiak. Kjo është çështje që mbetet të shihet në seancë", është shprehur Krasniqi.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së ka treguar se Lista Serbe deri më tani nuk ka dhënë ndonjë qëndrim përfundimtar për këtë çështje. Sipas Krasniqit, ky subjekt politik, në komunikimet që kanë pasur deri më tani, as nuk e ka mbështetur e as nuk e ka refuzuar këtë marrëveshje. "Lista Serbe është pjesë e koalicionit dhe është e natyrshme të kemi komunikim me të edhe për këtë çështje, sikurse kemi edhe për çështje të tjera. Deri më tani nuk kemi hasur në kundërshtim eksplicit nga ana e deputetëve të tyre. E vërteta është se ata deri më tani nuk na kanë njoftuar për një qëndrim pozitiv në mbështetje të Projektligjit për marrëveshjen e demarkacionit", është shprehur Krasniqi, duke mohuar mundësinë që Lista Serbe votën e saj për demarkacionin e ka kushtëzuar me ndonjë çështje tjetër.

**"Epoka e re":** *Z. Krasniqi, çfarë është diskutuar në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit e cila është mbajtur të martën?*

**Krasniqi:** Mbledhja e Kryesisë së Kuvendit ka qenë e orientuar drejt vazhdimit të seancës së mbetur në gjysmë dhe, po ashtu, është diskutuar për fillimin e seancës së re meqenëse ka një numër të madh të pikave të cilat janë në pritje, duke përfshirë edhe projektligje në lexim të parë dhe në lexim të dytë. Sa i përket ratifikimit të Projektligjit për marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi, siç e dini, tashmë është përcaktuar që

# kalojë demarkacioni



seanca e nisur të vazhdojë të mërkurën në orën 10:00. Pra, do ta vazhdojmë punën sipas këtij plani.

**"Epoka e re":** *Gjithë vëmendja e opinionit të mërkurën do të jetë kah Kuvendi. Koalicioni qeverisës, së bashku me LDK-në, i kanë votat e mjaftueshme për ratifikimin e demarkacionit?*

**Krasniqi:** Vlerësoj se më e rëndësishme ka qenë të arrihet një konsensus sa më i gjerë i partive në pushtet dhe atyre në opozitë për çështjen e demarkacionit. Ne jemi të kënaqur që pas bisedave intensive kemi arritur ta kemi një pajtueshmëri edhe me LDK-në. Për fat të keq, përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje vazhdojnë ta kenë një qasje refuzuese dhe kundërshtuese ndaj marrëveshjes së demarkacionit pavarësisht prej deklaratës së përbashkët të dy presidentëve, e cila në mënyrë specifike i adreson shqetësimet që kanë ekzistuar më herët nga kundërshtuesit e demarkacionit. Sidoqoftë, ju e dini tashmë se numri i deputetëve të cilët janë pjesë e këtyre grupeve parlamentare që kanë konfirmuar mbështetjen për këtë marrëveshje nuk e kalon numrin 78, ndërsa për të pasur një ratifikim të suksesshëm nevojiten 80 vota. Sot për sot ne nuk mund të themi se kjo punë ka përfunduar. Mbetemi me shpresë se në momentin kur hidhet në votim Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit të jetë shumica e nevojshme për ta kaluar me sukses këtë projektligj.

**"Epoka e re":** *Ditë më parë kryeparlamentari Kadri Veseli nuk e ka përjashtuar mundësinë që demarkacionin ta votojnë edhe disa deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje. Besoni se kjo do të ndodhë në momentin e votimit?*

**Krasniqi:** Nuk mund të paragjykoj se si do të votojnë deputetët e këtij subjekti politik, por ajo që tashmë dihet është se ka deputetë brenda grupit të Vetëvendosjes të cilët nuk e ndajnë mendimin refuzues për demarkacionin të paraqitur nga krerët e kësaj partie. Kjo varet nëse do të kenë ata kurajë për të votuar në interes të qytetarëve të Kosovës e jo në interes të lidershipit partiak. Kjo është çështje që mbetet të shihet në seancë.

**"Epoka e re":** *Por Lista Serbe, e cila është pjesë e koalicionit qeverisës, ende nuk ka dhënë ndonjë qëndrim të qartë rreth kësaj çështje. Keni diskutuar me këtë subjekt politik dhe cili është qëndrimi i saj përfundimtar?*

**Krasniqi:** Lista Serbe është pjesë e koalicionit dhe është e natyrshme të kemi komunikim me të edhe për këtë çështje, sikurse kemi edhe për çështje të tjera. Deri më tani nuk kemi hasur në kundërshtim eksplicit nga ana e deputetëve të tyre. E vërteta është se ata deri më tani nuk na kanë njoftuar për një qëndrim pozitiv në mbështetje të Projektligjit për marrëveshjen e demarkacionit. Ne shpresojmë se në momentin e fundit, kur do të votohet projektligji, do të kemi më shumë se 80 vota, qofshin ato nga deputetët e Listës Serbe apo të Vetëvendosjes. Mirëpo deri në këto momente nuk kemi pasur një konfirmim zyrtar as prej Listës Serbe.

**"Epoka e re":** *Në komunikimin që keni pasur me Listën Serbe, ka kërkuar diçka në këmbim të votës për demarkacionin?*

**Krasniqi:** Nuk jam në dijeni për asnjë kërkesë specifike që ka pasur Lista Serbe. Nuk ka prezantuar deri më tani një qëndrim final në lidhje me çështjen e demarkacionit. Domethënë, çfarëdo çështje që ndërlidhet me kërkesat e këtij subjekti politik për ta votuar demarkacionin deri më tani është vetëm spekulim.

**"Epoka e re":** *Çfarë nëse në momentin e votimit nuk do t'i keni votat e mjaftueshme për ratifikim e kësaj marrëveshje?*

**Krasniqi:** Kjo është çështje hipotetike të cilën nuk do ta komentoj. Ne jemi optimistë se në momentin e hedhjes në votim do të kalojë Projektligji për marrëveshjen e demarkacionit.

# Limaj: Vendimi për themelimin e Nismës doli se ishte i drejtë

Me rastin e katërvjetorit të themelimit të Nismës Socialdemokrate, lideri i saj, Fatmir Limaj, ka thënë se kjo forcë politike i duhet Kosovës. Ai ka thënë se Nisma ka për synim mbrojtjen e qytetarit të saj dhe dallon prej partive të tjera

PRISHTINË, 27 SHKURT - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, në shënimin e katërvjetorit të themelimit të kësaj partie, ka thënë se subjekti që drejton është duke u rritur çdo ditë. Limaj ka thënë se Nisma ka për synim mbrojtjen e qytetarit të saj dhe dallon prej partive të tjera duke mbajtur fjalën për premtimet ndaj qytetarëve të saj. "Dua ta shfrytëzoj rastin t'u shpreh mirëseardhje në strukturat e partisë dhjetëra e qindra intelektualëve të Kosovës që formalisht e zyrtarisht do t'i bashkohen Nismës Socialdemokrate. Mirë se keni ardhur në familjen tuaj, me vizionin e saj që po shpalos në këta katër vjet", ka thënë Limaj. Sipas tij, sot po vërtetohet se vendimi për themelimin e Nismës doli se ishte i drejtë.

Limaj ka pohuar se Nisma Socialdemokrate tashmë ka 250 zyrtarë që kanë përgjegjësi shtetërore në nivel qendror dhe lokal. "Prej kur kemi filluar e deri sot janë mbi 250 zyrtarë shtetërorë që ka marrë përgjegjësi për ta drejtuar nivelin qendror shtetëror dhe lokal. Jemi parti që ka grupin e saj parlamentar në Kuvendin e Kosovës, por edhe në asambletë e komunave", është shprehur Limaj, duke shtuar se kjo forcë politike i duhet Kosovës.

Ndërkaq kryetari i Këshillit të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, në fjalimin e tij ka folur për të arriturat e partisë për këta katër vjet nga themelimi. Sipas tij, Nisma para katër vjetësh e nisi një rrugëtim të ri për të mirën e qytetarëve. Krasniqi ka theksuar se Nisma dallon nga partitë e tjera, duke e pasur në qendër qytetarin. Krasniqi bëri thirrje që qytetarët të bashkohen rreth partisë së udhëhequr nga Fatmir Limaj, pasi vetëm kështu mund të bëhen ndryshimet.



# MAShT-i i përkushtuar për ngritjen e cilësisë në edukimin parashkollor

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 27 SHKURT - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MAShT), Shyqiri Bytyqi, ka marrë pjesë të martën në debatin e organizuar nga Komisioni Parlamentar për Arsim, me temën "Rëndësia e organizimit dhe sfidat e edukimit parashkollor", në të cilin ishin të pranishëm edhe deputetët dhe përfaqësues të institucioneve parashkollore, përfaqësues të Institutit Pedagogjik të Kosovës dhe përfaqësues të GIZ-it. Me këtë rast, ministri Bytyqi fillimisht ka përgëzuar Komisionin Parlamentar për Arsim për organizimin e kësaj tryeze për kategorinë e parashkollorëve. Ai ka thënë se kjo tryezë për këtë kategori është tejet e rëndësishme dhe duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë pasi, sipas tij, këtu do të jetë edhe baza e synimit të MAShT-it për ngritjen e cilësisë në arsim. "Nëse ne do të arrijmë që në fazën fillestare të fëmijëve tanë të moshës 0-6 vjeçare të krijojmë kushte dhe gjithëpërfshirje që fëmijët të fillojnë një edukim çfarë e meritojnë sot në Kosovë, shumë më lehtë do ta kemi edhe në nivelet e tjera të sistemit arsimor në Kosovë", ka thënë Bytyqi.

Ministri Bytyqi ka pohuar se MAShT-i do të angazhohet për hartimin e një legjislacioni të qëndrueshëm për edukim gjithëpërfshirës, në veçanti për moshën e fëmijërisë së hershme. Ai ka thënë se ky edukim do të jetë në nivelin e duhur me standarde evropiane. Po ashtu, ministri Bytyqi ka thënë se në kuadër të Planit Strategjik për Zhvillimin e Arsimit 2017/21 është edhe gjithëpërfshirja e fëmijëve në moshën e re, ndërsa ka treguar se tani janë në fazën e draftimit të koncept-dokumentit për projektligjin për edukimin e fëmijëve në moshën e hershme. Ai ka theksuar se është duke u hartuar edhe drafti për kurrikulën bërthamë për moshën 0-5 vjeç, për hartimin e të cilit janë angazhuar ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë.



Ministri ka bërë me dije se MAShT-i ka për objektiv edhe trajnimin e stafit profesional të edukatoreve për moshën 0-3 vjeç (rreth 100 sish) gjë që, sipas tij, do të ndodhë gjatë periudhës prill - nëntor të këtij viti, si dhe trajnimi i edukatorëve për moshën 3 deri në 5 vjeç, që planifikohet të zhvillohet gjatë periudhës korrik-gusht 2018, ku do të përfshihen shtatë institucione publike.

Ministri Bytyqi ka vlerësuar se të gjitha këto flasin për synimin e përgjithësim që edukimi parashkollor të ofrojë shumëllojshmëri të programeve, nivel të lartë profesional të punës me fëmijë, mundësi të shumta për zhvillimin optimal të fëmijëve tanë në moshën e re.

# MPB-ja rishikon strategjinë kombëtare kundër trafikimit të njerëzve



PRISHTINË, 27 SHKURT (ER) - Në Prishtinë është duke u mbajtur punëtoria për vlerësimin, rishikimin dhe amendamentin e planit vjetor të punës së strategjisë kombëtare kundër trafikimit të njerëzve 2015-2019.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, njëherësh edhe koordinator kombëtar i strategjisë kombëtare kundër trafikimit të njerëzve, Milan Radojeviq, ka theksuar se trafikimi i njerëzve është një temë shumë e rëndësishme. "Luftimi i trafikimit të qenieve njerëzore është një sfidë globale, ku edhe Kosova nuk bën përjashtim. Duhet të kemi bashkëpunim me të gjithë grupin, me qëllim që të ketë rezultate dhe të ketë trajtim më të mirë për viktimat e trafikimit", ka thënë zëvendësministri Radojeviq, me ç'rast ka falënderuar OSBE-në për mbështetje të vazhdueshme kësaj strategjie. Ai ka theksuar përkushtimin e tij që së bashku me të gjithë partnerët të bëhet përpjekje maksimale për parandalimin, trajtimin dhe strehimin e viktimave të trafikimit.

Ndërsa Vesna Vujoviq nga misioni i OSBE-së ka pohuar se Kosova mbetet një vend i origjinës dhe transiti i viktimave të trafikimit. "Deri më tani janë identifikuar 32 viktima, që mbetet një numër i madh për një vend si Kosova", ka thënë Vujoviq, duke bërë me dije se OSBE-ja mbetet e përkushtuar për ta vazhduar mbështetjen për MPB-në.

# Kosova vendos marrëdhënie diplomatike me Bangladeshin

Prishtinë, 27 shkurt (ER) - "Vendosja e marrëdhënieve diplomatike në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës Popullore të Bangladeshit është lajm i mirë dhe një hap tjetër në drejtim të rritjes dhe thellimit të bashkëpunimit në mes dy vendeve", kështu ka thënë zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, pas nënshkrimit të marrëveshjes për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Bangladeshin.

Pacolli ka thënë se Kosova do ta vazhdojë praktikën e tillë të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe ta shtrijë praninë dhe përfaqësimin diplomatik gjithandej nëpër botë.



Marrëveshja është nënshkruar nga përfaqësuesi i përhershëm i Bangladeshit në Kombet e Bashkuara, ambasadori Masud Bin Momen, dhe nga konsullja e përgjithshme e Republikës së Kosovës në Nju Jork, Teuta Sahatqija.

Nëpërmjet kësaj marrëveshje, dy qeveritë janë pajtuar t'i thellojnë marrëdhëniet miqësore në mes të dy vendeve, t'i zgjerojnë fushat e bashkëpunimit dypalësh, si dhe ta ndihmojnë njëra-tjetrën në rrafshin e politikës ndërkombëtare.

Të frymëzuar nga parimet e Kartës së OKB-së, të dy shtetet janë zotuar se do të angazhohen për respektimin e sovranitetit dhe integritetit territorial dhe ndihmës për promovimin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Për qëllime dokumentimi dhe praktike, marrëveshja është deponuar edhe në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Bangladeshi ka njohur Republikën e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran në muajin shkurt të vitit të kaluar.

Delegacioni i Kosovës dhe i Serbisë kanë përfunduar të martën raundin e bisedimeve në kuadër të dialogut teknik në Bruksel

# Në mars vazhdon dialogu edhe ndërmjet presidentëve

**Zëdhënësja e shefes së BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Maja Kocijançiq, ka bërë me dije se dialogu teknik në mes të Kosovës dhe Serbisë do të vazhdojë në muajin e ardhshëm, ku do të diskutohet sërish për zbatimin e marrëveshjeve të arritura më herët në Bruksel. Ajo ka theksuar se gjatë muajit mars pritet të mbahet edhe takimi i nivelit politik ndërmjet presidentëve të dy vendeve**



EPOKA E RE Faton DERMAKU

PRISHTINË, 27 SHKURT - Delegacioni i Kosovës dhe i Serbisë kanë përfunduar të martën raundin e bisedimeve në kuadër të dialogut teknik në Bruksel, i cili ka nisur të hënën. Të dy delegacionet për dy ditë rresht kanë biseduar për zbatimin e marrëveshjeve të ndryshme të cilat janë arritur në kontekstin e dialogut, lirinë e lëvizjes, Menaxhimin e Integruar të Kufirit (IBM-në), drejtësinë, Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, urën në Mitrovicë dhe energjetikën.

Zëdhënësja e Bashkimit Evropian, Maja Kocijançiq, ka bërë me dije se diskutimet kanë qenë konstruktive dhe delegacionet kanë biseduar për shumë çështje dhe hapa, për të cilat tash do të punojnë, në kuptimin që të arrihet deri te zbatimi i tyre dhe për normalizimin e ardhshëm të marrëdhënieve. "Në këtë kontekst, ata do t'i vazhdojnë bisedimet muajin e ardhshëm dhe do të punojnë për zbatimin e marrëveshjeve për lirinë e lëvizjes, IBM-së, Asociacionit apo Bashkësisë, për urën në Mitrovicë dhe për energjetikën", ka thënë Kocijançiq.

Ajo ka theksuar se gjatë muajit mars, në kuadër të dialogut në Bruksel, pritet të mbahet edhe takimi i nivelit politik ndërmjet presidentit të Kosovës dhe atij të Serbisë, Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiqit. "Kjo duhet të ndodhë muajin e ardhshëm. Ende nuk i kemi detajet", ka thënë Kocijançiq.

Dialogu, në nivelin teknik, ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ishte ndërprerë më 16 janar, nga delegacioni i Serbisë, pas vrasjes, në rrethana ende të pasqaruara, të njërit prej përfaqësuesve politikë të serbëve të Kosovës, Oliver Ivanoviq. Më herët, Bashkimi Evropian ka mirëpritur gatishmërinë e presidentëve të Kosovës dhe të Serbisë, Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiq, për ta vazhduar dialogun për normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve.

Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve ka nisur në vitin 2011, fillimisht si dialog për çështje teknike, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Që nga ajo kohë janë arritur një numër i konsiderueshme i marrëveshjeve, por disa nga to ende nuk janë zbatuar. Dialogu më pas është zhvilluar edhe në nivelin politik, ndërmjet kryeministrave dhe presidentëve të dy vendeve.

# Ekspertët kroatë do ta ndihmojnë shëndetësinë e Kosovës



PRISHTINË, 27 SHKURT (ER) - Operacione dhe ndërhyrje me metodologjinë më të re në kardiokirugji dhe kardiologji, trajtime profesionale për pediatrinë dhe shërbime të shpejta dhe me standardet më të larta, do të ketë shumë shpejt edhe në Kosovë, me ndihmën e ekspertëve kroatë të shëndetësisë. Kjo do të bëhet e mundur falë vizitës produktive të ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në Kroaci. Pas takimit me ministrin kroat të Shëndetësisë dhe udhëheqësit e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore kroate, ministri Ismaili, së bashku me drejtorin e ShSKUK-së, Basri Sejdiun, kanë vizituar të martën Qendrën Klinike Universitare të Rebros.

Në takimin me drejtorin e kësaj qendre Ante Çorusic, ministri Ismaili ka kërkuar të krijohen më shumë ura bashkëpunimi në mes të dy qendrave klinike universitare. Specifikisht, të shtohet ndihma mjekësore kroate, si një vend me mjekësi të zhvilluar për Kosovën. "Si një shtet mik, edhe kësaj radhe kemi trokitur në derën tuaj që ta forcojmë bashkëpunimin tonë. Të kemi më shumë shkëmbime profesionale, trajnime të profesionistëve tanë shëndetësorë", ka thënë ministri Ismaili. Ndërsa drejtori i Klinikës Universitare të Rebros, Ante Çorusic, ka theksuar se ata do të jenë gjithmonë në gatishmëri për ta mbështetur personelin mjekësor dhe pacientët e Kosovës në të gjitha format e kërkuara. Pas këtij takimi, ministri Ismaili ka vizituar disa prej klinikave më të rëndësishme të kësaj qendre, si Emergjencën, Pediatrinë, Kardiokirurgjinë dhe Kardiologjinë, ku është njoftuar me praktikat e punës në këto klinika.

Bashkë me drejtorët e këtyre klinikave u pajtuan që në javët e ardhshme të konkretizohet bashkëpunimi me marrëveshje konkrete, përmes së cilës do të përfitonin më së shumti personeli mjekësor dhe pacientët e Kosovës.

# Suedia ndihmon Kosovën me 3.2 milionë euro



PRISHTINË, 27 SHKURT (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, dhe i ngarkuari me punën e ambasadorit të Suedisë në Kosovë, Anders Wollter, ka firmosur të martën marrëveshjen për vazhdimin e mbështetjes financiare për projektin e sistemit të tatimit në pronë "Pro Tax 2", në një shumë prej 3.2 milionë eurosh.
Ministri Hamza ka falënderuar ambasadorin e Suedisë, Anders Wollter, për angazhimin e shtetit suedez për ta ndihmuar Kosovën përmes projektit "Pro Tax 2", si dhe ka vlerësuar ecurinë e deritanishme të bashkëpunimit, duke e konsideruar projektin "Pro Tax" si një nga projektet më të suksesshme të Ministrisë së Financave. Ai ka thënë se firmosja e kësaj marrëveshje shënon vullnetin e qartë të palës suedeze dhe asaj të Kosovës për thellimin e bashkëpunimit në drejtim të ndërtimit të një sistemi efikas dhe modern për administrimin e tatimit në pronë, në veçanti regjistrimin e pronave, tokave.
Ndërsa i ngarkuari me punën e ambasadorit të Suedisë në Kosovë, Anders Wollter, ka falënderuar ministrin Hamza për zotimin dhe angazhimin për implementimin e marrëveshjeve me shtetin suedez, duke shtuar se është shumë i lumtur që sot arritën të nënshkruajnë këtë marrëveshje. "Jam i bindur se kjo marrëveshje është shumë e domosdoshme për shtetin e Kosovës. Duke pasur parasysh implementimin e suksesshëm të marrëveshjeve paraprake, besoj se kjo nuk do të jetë marrëveshja e fundit, por pas kësaj do të vazhdojmë edhe me marrëveshje të tjera", ka deklaruar Wollteri.

# Beqaj: Rritja ekonomike në Kosovë do të bazohet në ekonominë e dijes

GJILAN, 27 SHKURT (ER) - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka marrë pjesë në Konferencën Rajonale për Teknologji Informative dhe Komunikime, e cila është mbajtur të martën në Gjilan. Në fjalën e tij në hapje të kësaj konference, ministri Beqaj ka folur për rëndësinë e zhvillimit të teknologjisë në shërbim të zhvillimit ekonomik të Kosovës, duke inkurajuar të gjithë ata që kanë ide inovative dhe duke siguruar se Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë do t'i përkrahë idetë e tyre. "Ndërmarrësit modernë kosovarë do të krijojnë punësim dhe eksport të shërbimeve, siç edhe po ndodh aktualisht. Fokusi ynë mbetet në zhvillimin e ndërmarrësisë dhe iniciativës private. Është koha për riorientim të ekonomisë sonë drejt ekonomisë digjitale, që Kosova të jetë qendër rajonale e zhvillimit të ekonomisë digjitale", ka deklaruar Beqaj. Ai ka theksuar edhe rëndësinë që ka ekonomia e dijes në rritjen ekonomike të vendit, duke theksuar nevojën e përdorimit të dijes në fushën e teknologjisë në të mirë ekonomike. Ministri Beqaj ka përshëndetur organizimin e kësaj konference dhe ka prezantuar angazhimet e ministrisë që drejton në rritjen e Fondit për Inovacion përmes bashkëpunimit në bashkim fondesh me organizatat e fuqishme, partnerë strategjikë të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe Qeverisë së Kosovës.



# Gjilani përfiton 13 milionë euro për rrugë



GJILAN, 27 SHKURT (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka vizituar të martën Komunën e Gjilanit, të Vitisë dhe atë të Kamenicës. Këto vizita u bënë në kuadër të bashkëpunimeve ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj lokale, ku edhe u nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të projekteve infrastrukturore për këto tri qytete.
Ministri Lekaj dhe kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për ndërtim të rrugëve në vlerë prej 13 milionë eurosh. Me këtë marrëveshje do të ndërtohet rruga në Verbicë të Zhegocit (1.3 milionë), në Përlepnicë (520 mijë euro), Cernicë (450 mijë euro), rruga "Pajazit Ahmeti" (110 mijë euro), rrugicat tek "Rruga e Prishtinës" (200 mijë euro) dhe vazhdimi i projekteve të vitit 2017 në vlerë prej 2.6 milionësh.
Me mbështetjen e BERZh-it do të bëhet zgjerimi i hyrje-daljeve Gjilan - Prishtinë dhe Gjilan - Ferizaj në vlerë prej 8.5 milionë eurosh. "Me këto investime, cilësia e jetës së qytetarëve do të jetë dukshëm më e mirë. Ky është një prej lajmeve më të mira për gjilanasit", ka thënë kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri.
Ministri Lekaj edhe gjatë takimit me kryetarin e Vitisë, Sokol Haliti, ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi. Lekaj u zotua para udhëheqësve dhe qytetarëve të Vitisë, se kjo komunë do ta marrë mbështetjen e merituar sa iu përket projekteve infrastrukturore dhe se Ministria e Infrastrukturës do të jetë çdoherë në mbështetje të kësaj komune, njëjtë sikurse për të gjitha komunat e tjera në Kosovë. Ndërsa kryetari i kësaj komune, Sokol Haliti, duke e cilësuar këtë takim të frytshëm, e ka falënderuar ministrin Lekaj për mbështetjen e dhënë dhe gatishmërinë për bashkëpunim.

# Metalet, shtylla kryesore e eksportit të Kosovë

Albulena S. MAVRAJ



PRISHTINË, 27 SHKURT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të martën të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin janar 2018. Sipas ASK-së, të dhënat nga Tregtia e Jashtme në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 36 për qind në muajin janar 2018, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2017, gjegjësisht në vlerë prej 170.5 milionë eurosh krahasuar me deficitin prej 125.4 milionë eurosh në vitin 2017. Sipas këtij raporti, eksporti mbulon importin me 12.6 për qind. "Eksporti i mallrave në muajin janar 2018 kishte vlerën 24.5 milionë euro, ndërsa importi 195 milionë euro, që është një rritje prej 14.3 përqindësh për eksport dhe një rritje prej 32.8 përqindësh për import, duke e krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017", është thënë në raportin e ASK-së. Sipas këtij raporti, të dhënat e grupeve kryesore të eksportit janë: 43.4 për qind të eksporteve e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 11.5 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 10.4 për qind e përbëjnë produktet minerale; 9.0 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 4.5 për qind e përbëjnë lëkura dhe artikujt prej saj; 4.3 për qind e përbëjnë produktet bimore; 4.0 për qind e përbëjnë tekstili dhe artikujt prej tij etj.

Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore për import janë: 19.5 për qind të importit e përbëjnë produktet minerale; 12.6 për qind e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 11.5 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 10.5 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 7.8 për qind e përbëjnë mjetet e transportit; 6.4 për qind e përbëjnë produktet e industrisë kimike; 5.5 për qind e përbëjnë produktet bimore; 5.4 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre etj.

"Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 6.3 milionë euro ose rreth 25.8 për qind e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 15.5 përqindësh. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE janë: Gjermania (6.1 për qind), Holanda (4.4 për qind), Bullgaria (2.8 për qind) dhe Italia (2.6 për qind)", është thënë në raportin e ASK-së.

Ndërkaq, sa iu përket importeve sipas ASK-së, importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 83 milionë euro ose 42.5 për qind e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 30.1 përqindësh. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga Gjermania (9.9 për qind), Italia (5.3 për qind), Rumania (4.9 për qind) dhe Greqia (3.2 për qind). "Në muajin janar 2018 eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 9.7 milionë euro ose 39.6 për qind të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 38.8 përqindësh. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Shqipëria (13.7 për qind), Maqedonia (10.2 për qind), Mali i Zi (6.4 për qind) dhe Serbia (5.7 për qind). Ndërsa, importet nga vendet e CEFTA-s në muajin janar 2018 arritën në 53.4 milionë euro, ose 27.4 të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 44 përqindësh. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Serbia (15.9 për qind), Shqipëria (4.8 për qind), Maqedonia (4.0 për qind) dhe B & H (2.4 për qind)", është thënë në raportin e ASK-së. Sipas këtij raporti, eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 8.4 milionë euro ose 34.6 për qind.

Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmenden, India (22.3 për qind) dhe Zvicra (6.0 për qind). Ndërsa importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 58.5 milionë euro ose 30 për qind. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Kina (9.8 për qind) dhe Turqia (8.3 për qind).



# Sala Berisha-Shala lavdëron punën e AAC-së

PRISHTINË, 27 SHKURT (ER) - Kryetarja e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, Sala Berisha-Shala, ka vizituar të martën Autoritetin e Aviacionit Civil (AAC), në kuadër të aktiviteteve të rregullta të mbikëqyrjes së agjencive të pavarura që i raportojnë këtij komisioni.

Berisha-Shala u prit në takim nga Samet Dalipi, kryesues i Bordit Mbikëqyrës të AAC-së, i cili e ka informuar atë për aktivitetet e AAC-së, të arriturat në aspektin e zbatimit të legjislacionit të BE-së, për sfidat me të cilat ballafaqohet AAC-ja, si dhe për veprimet e ndërmarra me qëllim të zbatimit të rekomandimeve të Komisionit për raportin vjetor të AAC-së për vitin 2015.

Sala Berisha-Shala ka përgëzuar AAC-në për punën e mirë dhe ka rikonfirmuar gatishmërinë e komisionit për mbështetje të vazhdueshme. Ajo ka thënë se AAC-ja është një agjenci shembull që tejkalon barrierat për t'i realizuar synimet strategjike.

## Themelohet organi i përhershëm për paratë virtuale

PRISHTINË, 27 SHKURT (ER) - Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt ka themeluar një organ të përhershëm për vlerësimin dhe adresimin e sfidave rregullative lidhur me paratë virtuale. "Ky organ i strukturuar në formën e një grupi këshillues do t'i përcjellë dhe analizojë zhvillimet ndërkombëtare për rregullimin e parave virtuale, me fokus për trajtimin e tyre nga rregullatorët në vendet e BE-së dhe vendet e rajonit, si dhe do të përgatisë rekomandime për organet vendimmarrëse të BQK-së lidhur me hapat e mëtejmë në funksion të rregullimit të parave virtuale", është thënë në komunikatën e BQK-së.

Në këtë komunikatë thuhet se BQK-ja ka qenë e angazhuar në mënyrë aktive në adresimin e çështjeve të lidhura me paratë virtuale, duke analizuar zhvillimet relevante, duke kontaktuar autoritetet përgjegjëse në vendet evropiane, si dhe duke komunikuar me publikun qoftë përmes komunikatave të veçanta, qoftë përmes deklaratave dhe prononcimeve të zyrtarëve të saj. "BQK-ja vazhdon t'ua tërheqë vëmendjen subjekteve vendore lidhur me rrezigjet për humbjet financiare që mund t'i pësojnë nga investimi në para virtuale, si dhe lidhur me implikimet e tjera të mundshme", është theksuar në komunikatën e BQK-së.

## Sot shënohet 20-vjetori i masakrës së Likoshanit dhe Qirezit

**Skenderaj, 27 shkurt (ER)** - Komuna e Skenderajt, në bashkëpunim me Komunën e Drenasit, sot (e mërkurë) do të organizojnë aktivitete me rastin e 20-vjetorit të betejës, masakrës së Likoshanit dhe Qirezit. Këshilli Organizativ i Komunës së Skenderajt dhe Drenasit, me rastin e kësaj ngjarje, kanë paraparë organizimin e këtyre aktiviteteve: në orën 9:00 homazhe në Varrezat e Dëshmorëve dhe Martirëve të rënë në betejën e Likoshanit dhe Qirezit; në orën 11:00 akademi përkujtimore nën përkujdesjen e presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, e cila do të mbahet në Bibliotekën Kombëtare "Pjetër Bogdani" në Prishtinë dhe në orën 15:00-17:00 vizitë familjeve të dëshmorëve dhe martirëve të rënë në betejën e Likoshanit dhe Qirezit.

# Haskuka ndal ndërtimet pa leje

Prizren, 27 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka thënë se është duke përmbushur zotimin për ndaljen e ndërtimeve pa leje, duke treguar disa raste të intervenimit të Inspektoratit të Komunës. Haskuka ka thënë se vetëm të hënën është intervenuar në tri raste. "Në rastin e parë janë ndaluar punimet në rrugën 'Ersan Mazrek' për shkak të intervenimit të paautorizuar nga kompania ndërtimore në hapësirën publike, gjegjësisht në zgjerimin e trotuarit. Në rastin tjetër është ndaluar një mbindërtim në banesat në lagjen 'Ortakoll'. Në marrëveshje me pronarin e banesës, objekti në 'Ortakoll' po kthehet në gjendjen e mëhershme. Rasti i tretë ka të bëjë me një zgjerim të objektit privat në hapësirën publike në rrugën 'Edith Durham'. Objekti ka filluar së ndërtuari gjatë fushatës zgjedhore, në mungesë të mbikëqyrjes nga qeveria e kaluar. Në marrëveshje me Drejtorinë e Inspektoratit, pronari ka filluar rrënimin e objektit, ndërsa hapësira publike duhet të kthehet në gjendjen e mëparshme", ka thënë Haskuka.





# RRUGËT NË PRISHTINË JANË TË KALUESHME

**Prishtinë, 27 shkurt (ER)** - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se ditët e fundit, për shkak të reshjeve të shumta të borës, tetë kompani të kontraktuara janë angazhuar me kapacitete të plota për pastrimin e rrugëve. "Si rezultat i punës së tyre, si dhe angazhimit maksimal të stafit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtorisë së Inspeksionit, rrugët kryesore në qytet dhe në fshatra janë të kalueshme", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Prishtinës. Komuna e Prishtinës u ka bërë thirrje pronarëve të lokaleve afariste të kujdesen për pastrimin e hapësirës para lokaleve të tyre dhe ta zbatojnë kështu Rregulloren për Shërbime Komunale, konkretisht nenin 138.

# Komuna e Suharekës u premton mbështetje grave fermere

**Suharekë, 27 shkurt (ER)** - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, i shoqëruar edhe nga nënkryetarja Mihrije Suka, ka takuar të martën disa nga gratë fermere të Komunës së Suharekës. Ky takim është zhvilluar në ambientet e Qendrës së Biznesit në Suharekë, ku pjesëmarrës ishin edhe përfaqësuesit e LDF-së në Suharekë.
Kryetari Muharremaj, pasi ka dëgjuar kërkesat e grave fermere, ka premtuar se në bashkëpunim me LDF-në do të ndihmojë ato, pasi profesioni që ato e kanë zgjedhur është profesion i vështirë për to. "Ne do ta ndihmojmë dhe mbështesim çdo qytetar i cili dëshiron dhe bën përpjekje për t'u marrë me biznes, edhe për juve do të bëjmë të pamundurën që t'ju përkrahim në punën tuaj", ka thënë kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj.



## Komuna e Prishtinës fillon faturimin e mbeturinave

**Prishtinë, 27 shkurt (ER)** - Në kuadër të reformës për menaxhimin e mbeturinave, Komuna e Prishtinës ka filluar ta bëjë edhe faturimin për këtë shërbim. Si rrjedhojë, qytetarët do t'i pranojnë faturat e mbeturinave në shtëpitë e tyre një herë në tre muaj. Këto fatura mund të paguhen në sportelet e komunës, në pikat e Postës së Kosovës (pa provizion), si dhe në bankat komerciale.
Për borxhet e vjetra që janë grumbulluar, qytetarët duhet të drejtohen në kompaninë "Pastrimi". Nëse nuk paguhen tri këste të njëpasnjëshme, komuna aplikon masa administrative ndaluese për shërbimet që ofrohen në drejtoritë: Drejtoria e Kadastrës, Drejtoria e Urbanizmit, e Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtoria e Financave, Drejtoria e Pronës, Drejtoria e Inspeksionit dhe Zyra e Prokurimit.



"MENDIME TË ZGJEDHURA PËR ADEM DEMAÇIN" (15)

# ADEM DEMAÇI KISHTE NDIKIM TË MADH NË OPINIONIN SHQIPTAR



Selatin NOVOSELLA

19. Gazeta "Epoka e re" (5 maj 2011): Adem Demaçi fajëson francezët për ndarjen e Mitrovicës

Gazeta e Prishtinës "Epoka e re" e sjell këtë vlerësim të Adem Demaçit për ndarjen e Mitrovicës: "Për gjendjen e krijuar në veri të Kosovës fajtor janë forcat franceze të KFOR-it, të cilat, pas përfundimit të luftës, u ndalën tek lumi Ibër, ndalën forcat e UÇK-së që të kalonin lumin dhe krijuan një situatë të volitshme për kriminelët dhe UDB-shët serbë, të cilët dalëngadalë përzunë rreth 20 mijë shqiptarë nga shtëpitë e tyre dhe e bënë serbizimin e pjesës veriore të Mitrovicës, atë që nuk e kishte bërë as krali në kohën e vet, as Tito dhe as Millosheviqi"!

20. Gazeta "Tribuna Shqiptare" (31 tetor 2011) - Adem Demaçi: "Fati i pashkruar i popujve të vegjël"

Veprimtari i shquar, Adem Demaçi, deklaron për gazetën prishtinase "Tribuna Shqiptare": "Varësia e institucioneve të Kosovës nga institucionet ndërkombëtare është dëshmi e fatit të pashkruar të popujve të vegjël, të cilët qëllimet e të drejtat e veta i arrijnë hap pas hapi".

21. Gazeta "Epoka e re" (31 dhjetor 2011) - Adem Demaçi: "Vuajtjet e mia i kam falur, kurse për ata që bënë krime ndaj popullit tim kam thënë: O Zot, mos ua fal!"

Baca Adem Demaçi, për gazetën "Epoka e Re" që botohet në Prishtinë, deklaroi: "Vuajtjet e mia personale kam pasur fuqi e urti t'ua falë të gjithë atyre që kanë marrë pjesë në ato punë të turpshme. Ndërkaq, sa u takon masakrimeve, vrasjeve, përdhunimeve dhe fshehjeve të krimeve mbi popullin e pafajshëm, gjithherë kam menduar, edhe tani mendoj e lutem: O Zot, mos ua fal!"

22. Gazeta "Lajm" (6 prill 2012) - Adem Demaçi s'dëshiron të jetë president ceremonial

Veprimtari i shquar i çështjes kombëtare, Adem Demaçi, thotë për gazetën prishtinase "Lajm", se nuk pranon të garojë për president të Republikës së Kosovës, edhe nëse e propozon ndonjë parti apo grup politik, pasi që, sipas tij, kompetencat e presidentit janë ceremoniale, e ai nuk dëshiron të jetë president sa për sy e faqe.

23. Gazeta "Epoka e re" (27 nëntor 2012): Mesazhi i Adem Demaçit për Festën e 28 Nëntorit

Baca Adem Demaçi, në vigjilje të Festës së Flamurit, për gazetën prishtinase "Epoka e re", jep këtë mesazh: "Të festojmë me bindje të sigurt se e ardhmja do të jetë më e mirë. Por, i kisha këshilluar shqiptarët të mësojnë nga përvoja e popujve të tjerë, të mësojnë nga përvoja e vet, të mendojnë me kokën e vet, të dinë se kriteri kryesor është kombi, të mos bëjnë asgjë që bie në kundërshtim me interesat e kombit, le t'ia kushtojnë krejt veprimet e veta kombit, e të mos habiten për disa dallavere të vogla, sepse krejt të tjerat shkojnë e vijnë e vetëm kombi mbetet"!

24. Gazeta "Telegraf" (28 nëntor 2012) - Adem Demaçi: "Nëse vendosni të vdisni para se me ra në burg, atëherë është pak më lehtë"

Kampioni i burgjeve të Jugosllavisë, Adem Demaçi, në intervistën për gazetën "Telegraf" të Prishtinës, deklaron: "Burgu është provë e madhe. Nëse vendosni të vdisni para se me ra në burg atëherë është pak më lehtë. Por, kam pa të tjerë sesi janë plakur, si janë mërzitë, si brengoseshin, humbnin nervat etj., sepse aty njeriu vdes një herë, dy herë, tre herë…! Sistemi i burgjeve të Serbisë e Jugosllavisë ka qenë i tillë. Ata janë munduar me mjeshtëritë e tyre të përsosura që të na hanë shpirtin, të na shkatërrojnë fizikisht dhe shpirtërisht. Ka qenë një makineri shumë dërmuese, shkatërruese, por, për fat, unë dhe shokët e mi, edhe pse ka pasur situata të ndryshme, kryesisht kemi kaluar mirë".

25. Gazeta "Epoka e re" (6 dhjetor 2012) - Adem Demaçi: "Qeverinë e Kosovës ta formojë PDK, AAK dhe LVV"

Duke folur për formimin e Qeverisë së ardhshme të Kosovës, veprimtari Adem Demaçi propozon: "Pres që krejt krahu i luftës, pra PDK-ja dhe AAK-ja, të hyjnë në një koalicion të përbashkët dhe nuk e di se çka po presin. Unë i kisha propozuar edhe Lëvizjes Vetëvendosje! Të heqë dorë nga ekstremet e ta gjejë mënyrën e të bashkohet në këtë koalicion. Është interesi i kombit të jemi sa më të bashkuar dhe sa më të fortë".

26. "Radio Evropa e Lirë" (5 janar 2013) - Adem Demaçi: "Të mos bërtasim për bashkimin kombëtar por të veprojmë për bashkim kombëtar"

Adem Demaçi, duke folur për bashkim e shqiptarëve në një shtet, në rrethanat e reja kombëtare dhe ndërkombëtare, konstaton: "Nuk është fjala të thyejmë lëvozhgën e vezës, fjala është që atë të verdhë të vezës që është brenda lëvozhge ta shndërrojmë në zog të gjallë. Në momentin kur ai zog merr shpirt, ai do ta shohë veten se është i kufizuar, se është i burgosur, dhe ai me sqepin e vet mekanikisht do të veprojë dhe do ta thyej atë lëvozhgë dhe del zogu, i cili është tri herë më i madh sesa kur ishte vezë dhe kur ishte brenda lëvozhgës. Këtë mënyrë duhet ta përdorin shqiptarët, pra të punojnë ngadalë dhe në mënyrë sistematike, pa folur e bërtitur dhe munduar ta bëjnë veten patriotë duke bërtitur se duan bashkimin kombëtar".

27. Gazeta "Express" (4 shkurt 2013): Adem Demaçi promovon kompletin e veprave të tij në Zvicër

Shkrimtari dhe veprimtari i shquar Adem Semaçi e ka promovuar kompletin prej dhjetë veprave të tij në Bernë të Zvicrës, pranë bashkatdhetarëve që jetojnë atje. Nga kritikët që referuan, vepra e Demaçit u shqua si metaforë për lirinë në përgjithësi dhe për lirinë e shqiptarëve në veçanti. Në fund të përurimit autori ua dhuroi veprat e tij ambasadorit të Shqipërisë në Zvicër, Mehmet Elezit, dhe ambasadorit të Kosovës në Zvicër, Naim Malajt.

28. Gazeta "Lajm" (12 prill 2013): Adem Demaçi përuroi kompletin e veprave të tij në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë

Shkrimtari dhe njëra prej figurave më të njohura në Kosovë, Adem Demaçi, përuroi kompletin e veprave të tij në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, në Tiranë. Demaçi çmohet, në radhë të parë, me shembullin e tij jetësor, por edhe me veprën e tij letrare.

29. Gazeta "Epoka e re" (27 maj 2013) - Adem Demaçi: "Po na akuzojnë neve që jemi viktima të luftës"!

Simboli i rezistencës shqiptare, Adem Demaçi, i ka quajtur të padrejta dhe të gabueshme arrestimet e ish-pjesëtarëve të UÇK-së nga EULEX-i. Ai tha: "Shqiptarët nuk kanë kryer krime lufte. Ata kanë bërë luftë të drejtë kundër pushtimit të Serbisë dhe se nuk duhet të barazohet viktima me kriminelin. Ndjekja e çlirimtarëve të Kosovës është duke e turpëruar demokracinë. Jam i habitur me heshtjen e miqve tanë amarikanë ndaj këtyre arrestimeve dhe gjykimeve"!?

30. "Epoka e re" (11 qershor 2013): Adem Demaçi përuroi kompletin e veprave të tij në Stamboll

Në organizimin e Qendrës Kulturore të Kosovës në Stamboll u bë përurimi i kompletit prej dhjetë veprave të veprimtarit të mirënjohur Adem Demaçit. Në përurim morën pjesë mysafirë nga fusha e artit, kulturës, letërsisë dhe veprimtarë të çështjes kombëtare. 31. "Radio Kosova e Lirë" (7 shkurt 2016): Njëzetë tregimet e Adem Demaçit më shumë se njëzetë romane

Njëzetë tregimet e para të Adem Demaçit, të shkruara në vitet e '50-ta të shekullit të kaluar, kanë ndikuar në publikun lexues të kohës më shumë se veprat e njëzetë shkrimtarëve dhe rrëfimtarëve të tjerë të cilët burim frymëzimi kishin "jetën e re" në Jugosllavinë e Josip Boz Titos.

32. "Radio Kosova e Lirë" (7 shkurt 2016): Në 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë botohet kompleti i veprave të Adem Demaçit

Në 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, botuar nga Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, doli në dritë kompleti i veprave të simbolit të gjallë të rezistencës kombëtare, shkrimtarit të mirënjohur, Adem Demaçi. Kompleti përfshin veprat: "Fërkime", "Gjarpinjtë e gjakut", "Libër për Vet Mohimin", "Heli dhe Mimoza", "Nëna shegë e pasë gocat", "Shkrumbnajë e dashuri", "Dashuria Kuantike e Filanti", "Alb Prometeu", "Politika dhe Pushka" dhe "Tung vargu im".

33. "POGROM": (Revistë gjermanoperëndimore): Adem Demaçi është shembull tipik i të burgosurit politik në Jugosllavi

Kur ke të bësh me të burgosurit politikë në Jugosllavi, atëherë të shpeshtën e rasteve, duhet përdorur konjuktivin, nga se është e njohur se të njëjtit të burgosur politikë për të njëjtat vepra nxirren para gjyqit dhe dënimet i kanë të ndryshme, madje edhe u zgjaten. Adem Demaçi, për këtë është shembull tipik.

34. "Zëri i Kosovës": Adem Demaçi i vetmi rast në Evropë dhe në Botë

Është i vetmi rast në Evropë, po edhe në botë, që një i dënuar politik, siç është rasti me Adem Demaçin, të mos lirohet nga burgu, përkundër të gjitha kërkesave e protestave të autoriteteve, të grupeve, të organizatave e shoqatave të shkrimtarëve.

35. "Zëri i Kosovës": Adem Demaçi dergjet në kampet e përqendrimit jugosllav

Në mos asgjë tjetër, 18 vjet të rënda dergjjeje të Adem Demaçit nëpër kampet jugosllave të përqendrimit si dhe 10 vjetët e tjera që i kanë mbetur atij për t'i mbajtur ende, vetëm e vetëm për bindjet politike, dëshmojnë për egërsinë e pashembullt dhe kalbëzimin e sigurt të Jugosllavisë titiste.

36. Gazeta "ÇLIRIMI": Adem Demaçi kishte ndikim të madh në opinionin shqiptar

Në vitin 1996 Adem Demaçi paralajmëroi se do të aktivizohej plotësisht në jetën politike të Kosovës. Kjo do të thotë se ai do të inkorporohet në subjektet ekzistuese të Kosovës, sepse Adem Demaçi edhe deri në vitin 1996 ka qenë plotësisht aktiv në jetën politike të Kosovës, madje me një ndikim jo të vogël në opinionin shqiptar. **(Vijon)**



# Trumpi bisedon me Korenë e Veriut nën kushtet e duhura

Presidenti Trump fajësoi paraardhësit e tij për progresin e ngadaltë për çështjen e Koresë së Veriut, ndërkohë që edhe sinjalizoi se ShBA-ja mund të jetë e gatshme të bisedojë me regjimin



UASHINGTON, 27 SHKURT - Presidenti Donald Trump po shpreh vullnetin për të biseduar me Korenë e Veriut, por "vetëm nëse krijohen kushtet e duhura".
Ai paralajmëroi se nëse Pheniani nuk braktis programet për armët bërthamore dhe ato për raketat balistike, mund të ketë një "humbje të jashtëzakonshme jetësh, në përmasat që askujt nuk i kanë shkuar ndonjëherë në mendje".
Presidenti Trump fajësoi paraardhësit e tij për progresin e ngadaltë për çështjen e Koresë së Veriut, ndërkohë që edhe sinjalizoi se Shtetet e Bashkuara mund të jenë të gatshme të bisedojnë me regjimin. "Ata duan të bisedojnë. Edhe ne dëshirojmë të bisedojmë, por vetëm në kushtet e duhura. Ndryshe, nuk ka bisedime. Siç e dini, ata kanë folur për 25 vjet. Presidentët e mëparshëm duhet ta kishin zgjidhur këtë çështje shumë kohë përpara meje. Pra, kanë folur për 25 vjet dhe e dini çfarë ndodhi? Asgjë", tha presidenti Trump.
Ndërsa përfunduan Lojërat Olimpike Dimërore në Pyeongchang, tashmë të gjithë sytë janë përqendruar sërish te kërcënimi bërthamor koreanoverior.
Të premten u shpallën sanksione të reja ndaj individëve dhe kompanive, si një përpjekje për t'i frenuar programet e Koresë së Veriut për prodhimin e raketave me rreze të gjatë.
E sapokthyer nga ceremonia përmbyllëse e Lojërave Olimpike, sekretarja e shtypit e Shtëpisë së Bardhë, Sarah Huckabee Sanders, përsëriti përparësitë e administratës. "Le të jemi plotësisht të qartë - rezultati i çfarëdolloj dialogu me Korenë e Veriut duhet të jetë eliminimi i armëve bërthamore. Deri atëherë, Shtetet e Bashkuara dhe bota duhet të vazhdojnë ta bëjnë të ditur se programet bërthamore dhe të raketave të Koresë së Veriut janë një rrugë pa krye", tha Sanders.
Tensionet arritën kulmin vitin e kaluar, kur gjatë një fjalimi në OKB, presidenti Trump e quajti udhëheqësin koreano-verior "njeriu raketë".
Kim Jong Un u kundërpërgjigj duke e quajtur vizitën e presidentit Trump në nëntor në Azi të presidentit Trump, "vizita e një luftënxitësi".
Analistët thonë se ende nuk dihet qartë se sa pranë lëshimit me sukses të një sulmi bërthamor gjendet Koreja e Veriut. "Në dallim nga fillimi i vitit të kaluar, Koreja e Veriut nuk i ka vazhduar provat. Pra, duhet ndjekur ky aspekt me vëmendje. Nëse i rifillojnë ato, atëherë mendoj se do të rikthehemi atje ku ishim", thotë Denny Roy, studiues në Qendrën "East-West". Me gjithë paralajmërimet nga Veriu, Koreja e Jugut dhe Shtetet e Bashkuara planifikojnë të zhvillojnë stërvitje të përbashkëta ushtarake në pranverë.

# Drejtorja e Komunikimit në Shtëpinë e Bardhë dëshmon në Kongres



UASHINGTON, 27 SHKURT - Drejtorja e Komunikimit e Shtëpisë së Bardhë, Hope Hicks, një nga ndihmëset më afatgjatë të presidentit Trump, po dëshmon përpara një komisioni të kongresit që po heton rreth lidhjeve të mundshme të zyrtarëve të fushatës së Trumpit me Rusinë.
Dëshmia me dyer të mbyllura po zhvillohet në Komisionin e Zbulimit në Dhomën e Përfaqësuesve. Para se të bashkohej me ekipin elektoral të Trumpit, Hope Hicks ishte zëdhënëse për marrëdhëniet me publikun për vajzën e Trumpit, Ivanka Trump, në biznesin e saj të veshjeve.
Javët e fundit komisioni thirri për dëshmi ish-këshilltarin e lartë të presidentit, Steve Bannon.
Shtëpia e Bardhë nuk e përdori atë që njihet si "privilegj ekzekutiv" për dëshminë e tij, por punoi për ta kufizuar gamën e pyetjeve të cilave ai do t'u përgjigjej, duke përgatitur një listë të tyre.
Nuk është bërë ende publike se me çfarë pyetjesh do të përballet 29 vjeçja Hicks. Paraqitja e saj në janar përpara të njëjtit komision u përfshi nga mosmarrëveshje lidhur me pyetjet të cilave do t'u përgjigjej.
Një pikë e hetimit të së mërkurës ka të ngjarë të përqendrohet në rolin e saj në hartimin e një deklarate kontradiktore, lidhur me një takim të qershorit 2016, të zhvilluar në kullën Trump në Nju Jork mes djalit të madh të Trumpit, Donald Trump Jr., dhëndrit të presidentit, Jared Kushner, si dhe menaxherit të fushatës Paul Manafort, me një avokate ruse.
Ligjvënësi republikan Michael Conaway, që drejton komisionin, tha dje se "nuk do të habitej" nëse Hicks do të refuzonte t'u përgjigjej pyetjeve të caktuara për arsyen se Trumpi ka kërkuar të zbatohet "privilegji ekzekutiv" për të mbajtur sekrete biseda që ai kishte zhvilluar me të.

## Tre vjet nga vrasja e Nemtsovit - kritik i Putinit




**Moskë, 27 shtator** - Miq, kolegë dhe mbështetës të politikanit të vrarë të opozitës ruse, Boris Nemtsov, shënuan të martën përvjetorin e tretë të vrasjes së tij. Politikani opozitar Ilya Yashing tha se një ceremoni do të mbahet në Qendrën Sakharov të Moskës, ku do të shfaqet një ekspozitë me fotografi të Nemtsovit të bëra në periudha të ndryshme të jetës së tij.
Më 25 shkurt mijëra njerëz kanë marshuar në Moskë dhe qytete të tjera të Rusisë për ta kujtuar Nemtsovin, kritik i zëshëm i presidentit rus, Vladimir Putin. Ai është vrarë më 27 shkurt të vitit 2015, pranë ndërtesës së Kremlinit në Moskë.
Në korrik të vitit të kaluar, një gjykatë në Moskë ka shpallur fajtorë për vrasjen pesë burra nga rajoni i Çeçenisë dhe i ka dënuar ata me burgime të gjate. Por, të afërmit dhe bashkëpunëtorët e Nemtsovit thonë se vrasja e tij është urdhëruar nga nivele më të larta.

Qasje

# Bashkimi si synim inicial i jetës dhe i veprimtarisë së Demaçit

*(Selatin Novosella, "Demaçi - njeri i lavdisë", ShPBPK, Prishtinë, 2017)*

**Prof. dr. Shyqri GALICA**

Personaliteti i Adem Demaçit pa asnjë dyshim është i veçantë në një spektër të gjerë trajtimesh e hulumtimesh, një figurë dramatike nga jeta e hershme e tij deri në ditët tona, me ide e pikëpamje tejet të veçanta e, mbase, ndër më konstruktivet në historinë e kombit shqiptar.

Demaçi sot nuk e ka forcën që e kishte dje, por e ka veprimin më të fuqishëm, pikëpamjet e mendimet përcaktuese të fatit të popullit të tij, kurse vizionin të jashtëzakonshëm. Natyrisht, e ka veprimin më të fuqishëm, sepse idetë e tij tashmë kanë pushtuar jetën shqiptare dhe, faktikisht, kanë përshkuar katër anët e botës. Të gjitha këto ka arritur t'i masivizojë nëpër vite të rënda pa kursyer asgjë, madje asgjë nga vetja e tij dhe duke u bërë prijës i idesë dhe i veprimit për bashkimin e trojeve shqiptare në një kohë tragjike, një fatkeqësi që do të marrë fund sipas pikëpamjeve të Adem Demaçit.

Mbase në një masë të mirë, nëpërmjet fragmenteve të zgjedhura të autorëve të ndryshëm, në librin "Demaçi - njeri i lavdisë", ka arritur ta portretizojë në masë të mirë përzgjedhësi i këtyre mendimeve, Selatin Novosella.

Duke ndjekur me shumë kujdes jetën e tij, ai herë pas here ka dalë para publikut me botime e ribotime të ndryshme: "Adem Demaçi në gjykimin e parë - 1958", "Adem Demaçi në gjykimin e dytë - 1964", "Adem Demaçi në gjykimin e tretë - 1975", "Lëvizja revolucionare për bashkimin e shqiptarëve sipas dokumenteve arikivore", "Demaçi - metaforë lirie" (mendime dhe vlerësime të rreth 100 vetave për Demaçin), "Demaçi - aromë atdheu" (me poezi të 80 krijuesve të ndryshëm kushtuar Demaçit) dhe "Viti i Adem Demaçit", botuar me rastin e 80-vjetorit të lindjes ës tij.



Ndërkaq, botimi që kemi në duar është një përmbledhje me mendime e vlerësime të dyqind personaliteteve të ndryshme, që në të vërtetë është një punë shumë e madhe e autorit që ka bërë për të mbledhur si bleta nektarin vlerat më të mira, mendimet e pikëpamjet e atyre që kanë artikuluar për jetën dhe veprën e atdhetarit, politikanit e shkrimtarit Adem Demaçi.

Janë mendime që në libër janë vënë sipas alfabetit, duke mos dalluar nivelin e autorëve, edhe pse janë mendime të autoriteteve më të larta, deri tek ato të rëndomtat. Në libër nuk janë përfshirë vetëm mendimet e shqiptarëve gjithandej, por edhe të personaliteteve të ndryshme të botës, të cilat për figurën e Adem Demaçit janë shprehur me shumë admirim.

Por duke menduar që ta bënte më të plotë portretin e Adem Demaçit, autori në një kapitull ka dhënë mendime, vlerësime, qëndrime dhe analiza për ngjarje e situata të ndryshme të Demaçit, që janë zhvilluar në mjediset tona. Prandaj, kjo pjesë e bën edhe më interesant librin dhe jep mundësi për t'i ndjekur shqetësimet dhe synimet që kishte ai në periudha e procese që zhvilloheshin në Kosovë e më gjerë. Gjithashtu, në këtë botim janë përfshirë aspekte të shkrimeve të revistave e të gazetave të ndryshme të vendit e të botës.

Në fund, pos burimeve dhe literaturës nga janë vjelë këto mendime, jepet edhe një pasqyrë e çmimeve dhe e mirënjohjeve që ndër vite i ka marrë Demaçi nga struktura të ndryshme shoqërore, politike e letrare.

Pa dyshim, libri "Demaçi - njeri i lavdisë" i Selatin Novosellës, që e botoi Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, është dhe një kontribut i radhës i autorit dhe gjithsesi një ndihmesë për ta vazhduar kërkimin dhe studimin më të thelluar të jetës dhe të veprës së Adem Demaçit, të njeriut që diti të kërkojë, të artikulojë e të veprojë për dashurinë ndaj atdheut e lirisë, madje në formën që nuk e bëri asnjë i dytë. Mendimi dhe synimi inicial i tij, qe bashkimi i trojeve shqiptare dhe, pa dyshim, i tillë do të mbetet deri në realizimin e tij.

# Refuzimi i frustruar i dekoratave të lirisë



**Sali BISLIMI**

Refuzimi i dekoratave të presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, të ndara me rastin e 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës nga disa personalitete, dëshmon ligësinë e tyre karshi një vlerësimi institucional e shtetëror për punën dhe aktivitetin e tyre shumëvjeçar.

Refuzimi vë në pah frustrimin e tyre dhe mosrespektin ndaj institucionit të Republikës së Kosovës, në këtë rast presidentit të vendit dhe jubileut të dhjetë të shpalljes së Deklaratës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës. A thua këta individë (patriotë) të cilët refuzuan këtë dekoratë, a do ta kishin bërë një gjë të tillë sikur të ishin shpërblyer nga Marshall Tito, Enver Hoxha, Mehmut Bakalli apo Fadil Hoxha? Nuk e besoj se do të kishin refuzuar një dekoratë nga ish-regjimi diktatorial komunist.

Është në nderin dhe traditën e popullit shqiptar që nëse dikush të nderon, së paku duhet me qenë mirënjohës për vlerësimin që ta ka bërë.

Ashtu sikur edhe mbretëresha pranon një trëndafil për ta respektuar së paku gjestin e çdo kujt.

Presidenca e Kosovës dhe Komisioni Shtetëror i Vlerësimit të këtyre personaliteteve të dekoruara ka bërë punën e vet ashtu siç duhet, kurse të refuzuarit na kanë bindur se nuk e kanë merituar të jenë të dekoruar, si dhe nuk janë të denjë të dekorohen për 10-vjetorin e lirisë dhe të pavarësisë së përgjakshme të Kosovës martire. Sa të lig e të mjerë u shfaqën këta njerëz para pasqyrës së tyre, vlerësimit shtetëror dhe opinionit publik. Ata do të duhet të kuptojnë se demokracia ndërtohet çdo ditë.

# Në Sarajevë fillon xhirimi i serisë së re televizive 'Konaku i Hilmisë'

**Prishtinë, 27 shkurt** - Në Sarajevë ka filluar xhirimi i serisë së re televizive "Konaku i Hilmisë" (Hilmijin Konak). Xhirimi i serisë së re "Hilmijin Konak" ka filluar të martën në Sarajevë. Në rolet kryesore, krahas aktorit të njohur kosovar, Ilir Tafa, do të luajnë edhe aktorët Emir Hadzihafizbegovic e Tarik Filipovic.

Xhirimet do të zgjasin disa muaj apo vite, ndërsa ngjarja është e vendosur në kohën e Luftës së Dytë Botërore.

Ekipi i produksionit, serialin e ri "Hilmijin Konak" e ka quajtur kafshatë e madhe për shkak të investimeve që janë bërë në të, duke u nisur nga skenografia, kostumografia dhe të gjitha elementet përcjellëse të realizimit të tij. Siç mësohet, ky projekt do të mbledhë rreth vetes edhe aktorët më të mirë nga të gjitha regjionet e ish-Jugosllavisë.

Aktori kosovar Ilir Tafa tashmë është vendosur në Sarajevë, ku do të qëndrojë për disa ditë në setin e xhirimit, për të lëvizur pastaj edhe në qendrat e tjera si në Zagreb, Podgoricë e vende të tjera ku do të realizohet seriali.



E rrallë

## Qeni kopjon shprehjet e pronarit



Liam Rice është një 24-vjeçar i cili i do shumë kafshët. Ai ka një qen me emrin Luna, i cili kopjon çdo shprehje të fytyrës që bën pronari i saj. Fotografitë që ka postuar në rrjetet sociale Rice kanë arritur të shpërndahen shumë në internet.

FOTO E DITES



Një punëtor në Pakistan mbart tulla në shpinë. /Reuters/

E jashtëzakonshme

## Njihuni me djalin që bën 200 selfie në ditë




Junaid Ahmed ka 50 000 ndjekës në rrjetin social "Instagram" dhe pranon se është i varur nga "selfit". 22-vjeçari i bën vetes afërsisht 200 shkrepje në ditë. Ai zgjedh me kujdes kohën kur do të postojë një fotografi në rrjetin social "Instagram" në mënyrë që të marrë sa më shumë pëlqime dhe nëse merr më pak se 600 të tilla, atëherë ai e fshinë fotografinë.

## BARSOLETA E DITËS



**Gruaja: Krejt rrogën po e harxhon t'u pi raki!**
**Burri: Edhe ti krejt rrogën po e harxhon për kozmetikë.**
**Gruaja: Po blej për me t'u dukë ty e bukur.**
**Burri: Edhe unë po pi për me mu dukë e bukur.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00**

## "FERDINAND" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 46 min

Rolet: John Cena, Kate McKinnon, Gina Rodriguez, Daveed Diggs, Gabriel Iglesias, Bobby Cannavale, David Tennant, Anthony Anderson, etj.
Regjia: Carlos Saldanha






**Në ora 18:00 dhe 20:00 (R)**

## "FIFTY SHADES FREED"

Dramë/Romansë/Triller; 1 orë 41 min

Rolet: Dakota Johnson, Jamie Dornan, Eric Johnson, Rita Ora, Luke Grimes, Victor Rasuk, Jennifer Ehle, Eloise Mumford, Max Martini, Callum Keith Rennie, Bruce Altman, Arielle Kebbel, Robinne Lee, Brant Daugherty, Marcia Gay Harden, etj.
Regjia: James Foley

**Në ora 22:00 (PG-13)**

## "THE COMMUTER"

Krim/Dramë/Mister; 1 orë 44 min

Rolet: Liam Neeson, Vera Farmiga, Patrick Wilson, Jonathan Banks, Sam Neill, etj.

Regjia: Jaume Collet-Serra




**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Vetëbesimi ju ka bërë të aftë të ndërmerrni hapa që më përpara i mendonit të parealizueshëm.



**DEMI**
Dita e sotme do të jetë një pikë kthese lidhur me të ardhmen tuaj. Tashmë keni vendosur të ndiqni objektiva të rinj.



**BINJAKËT**
Çdo nismë e juaja ka pasur pikësynime të qarta. Kjo e fundit nuk bën përjashtim nga të tjerat.



**GAFORRJA**
Keni disa situata të pazgjidhura në ambientin e punës që doni t'u jepni drejtim përpara se të ikni me pushime.



**LUANI**
Dita e sotme nuk do të jetë e qetë për ju. Keni lënë shumë gjëra për të zgjidhur dhe do t'ju mbivendosen shumë takime.



**VIRGJËRESHA**
Keni filluar të kurseni më shumë seç duhet dhe kjo gjë ju ka privuar nga shumë kënaqësi të vogla. Ndryshoni sjellje.



**PESHORJA**
Po prisni që një mik t'ju ftojë në një ballafaqim për t'i treguar se si kanë shkuar realisht gjërat.



**AKREPI**
Ditët e fundit nuk keni qenë aspak të qetë. Një shqetësim familjar ka marrë gjithë vëmendjen tuaj. Sot keni zgjidhur gjithçka.



**SHIGJETARI**
Do të prisni një telefonatë sot që, fatkeqësisht, nuk do të vijë. Do të jeni mjaft të heshtur gjatë gjithë ditës.



**BRICJAPI**
Sot do të keni mjaft aktivitete të ngjeshura. Në mbrëmje do ta shijoni qetësinë me partnerin.



**UJORI**
Keni vendosur të hiqni dorë nga një person që për ju ka qenë shumë i rëndësishëm. Rrethanat ju kushtëzojnë për një veprim të tillë.



**PESHQIT**
Do ta ndryshoni ritmin e ditës sot duke marrë përgjegjësi të reja mbi vete. Po tentoni të inkuadroni në një punë të re.

# Ish-bashkëshorti i Cherylt bëhet baba për herë të dytë



Ish-bashkëshorti i Cherylt, Ashley Cole, është bërë baba për të dytën herë, pasi e dashura e tij Sharon Canu ka lindur vajzën e saj të quajtur Grace këtë fundjavë. Sipas "The Sun", futbollisti 37-vjeçar, i cili tani luan për LA Galaxy në Kaliforni, e ka pritur mjaft mirë ardhjen në jetë të fëmijës së tij të dytë.




# Victoria Beckham heq dorë nga takat

Ikona e modës, Victoria Beckham, e cila është e njohur për stilin e të veshurit mjaft elegant, duket se për pak kohë do të heqë dorë nga takat e larta. Ka qenë vetë ikona e modës që në rrjetin social "Instagram" ka postuar një fotografi me këmbën e lidhur me fashë. Ajo ka bërë me dije se të ecurit me taka për një kohë të gjatë i ka shkaktuar një frakturë stresi në kockat e këmbës nga lodhja e vazhdueshme.

# Dasma e Princ Harry dhe Meghan Markle do të zhvillohet nën masa të rrepta sigurie



Një ndër ngjarjet më të rëndësishme të këtij viti është dasma mbretërore e Princ Harryt dhe Meghan Markle, e cila është caktuar më 19 maj. Por, një çështje e rëndësishme e kësaj ngjarje mbetet siguria. Ish-roja i princeshës Diana, Ken Wharfe, në një intervistë për "Entertainment Tonight" ka shpjeguar se siguria që është planifikuar gjatë dasmës mbretërore është e lartë. Wharfe ka pohuar se kur është fjala për sigurinë, asnjë shpenzim nuk do të kursehet.

# Rekordi i Ed Sheeran, artisti me më shumë shitje



Kantautorit britanik Ed Sheeran është shpallur artisti me më shumë shitje për vitin 2017, sukses ky që i detyrohet albumit "Divide" dhe hiteve "Shape of You" dhe "Perfect". Federata ndërkombëtare e industrisë fotografike ka thënë se "Divide", i publikuar në mars të 2017-s, ka shënuar rekord shitjesh në 36 vende. Balada e muzikës pop "Shape of You" u bë më e shitur në rang global për vitin 2017 dhe është certifikuar si "multi platinium" në 32 vende.




# Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ARKA GDYNIA - PIAST GLIWICE | 1 | GETAFE - DEPORTIVO LA CORUNA | 2 | MALAGA - SEVILLA | 2 |

# Krasniqi: Ndaj Prishtinës e duam fitoren e titullit

Trepça '89 është në kërkim të fitores së madhe që e inkuadron seriozisht në garën për titullin e kampiones në elitë. Kështu ka bërë me dije të martën për gazetë, Fesim Krasniqi. "Ndeshjen e radhës e kemi ndaj një kundërshtari me kualitet të njëjtë. Besoj se do t'ia dalim dhe t'i marrim pikët e plota. Ne jemi të uritur për një fitore të madhe që na inkuadron seriozisht në garë për titull të kampiones", ka thënë Krasniqi

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 SHKURT - Festim Krasniqi është i lumtur që Trepça '89 e ka nisur mirë sezonin pranveror në Vala Superligën e Kosovës në futboll, duke arkëtuar gjashtë pikë nga përballjet me Vëllanzimin nga Gjakova dhe Besën e Pejës. "Mund të themi se kemi bërë një fillim të mbarë në sezonin pranveror, sepse po arrijmë t'i arkëtojmë pikët maksimale në ndeshjet kampionale, kurse morali dhe atmosfera te ne nuk kanë munguar që nga fillimi i përgatitjeve, ku kemi punuar shumë duke i shfrytëzuar në maksimum kushtet që na janë ofruar në Antalia të Turqisë", ka thënë Krasniqi për "Epokën e re".



Më pas mesfushori ofensiv bëri me dije se skuadra nga "Riza Lushta" është në kërkim të fitores se madhe që e inkuadron seriozisht në garën për titull kurse, sipas tij, kjo fitore do të jetë në ndeshjen e radhës ndaj Prishtinës. "Ndeshjen e radhës e kemi ndaj një kundërshtari me kualitet të njëjtë. Besoj se do t'ia dalim dhe t'i marrim pikët e plota. Ne jemi të uritur për një fitore të madhe që na inkuadron seriozisht në garë për titull të kampiones", ka deklaruar ai.

Më pas ish-futbollisti i shumë skuadrave në Kosovë ka treguar se gjatë javës do të analizohen pikat e forta dhe të dobëta të Prishtinës. "Pikat e forta të Prishtinës nuk i di konkretisht, sepse ende nuk i kemi analizuar. Gjatë javës do të shohim ku i kanë pikat e forta dhe të dobëta në mënyrë që në ndeshje ta kemi më të lehtë", ka shtuar Krasniqi. "Pika e fortë te ne është grupi dhe puna që bëjmë si kolektiv. Falë Zotit nuk kemi lëndime që do të na paraqisnin pengesë për t'i arritur qëllimet tona, kurse mungesa e vetme në këtë ndeshje do të jetë ajo e Argjend Mustafës për shkak të kartonëve", ka përfunduar Krasniqi.

Kampionia aktuale e Kosovës, Trepça '89, renditet në pozitën e katërt me 33 pikë, tri pikë më pak se Drita e Gjilanit që e mban pozitën e parë.

# Sot fillon 'Final 8', premtohet spektakël basketbolli

"Uroj që gjithçka të shkoj sipas planit të paraparë dhe që të gjithë adhuruesit e basketbollit të kënaqen me këtë festë basketbolli, e cila do të fillojë të mërkurën dhe do të përfundojë të dielën", ka thënë Elvira Dushku

PRISHTINË, 27 SHKURT - Gjithçka është gati për "Final 8" të Kupës së Kosovës në basketboll. Kjo është konfirmuar në konferencën e organizuar të martën nga organizatori i kësaj ngjarje, KB Golden Eagel Ylli dhe Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK).

Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, ka përgëzuar KB Golden Eagle Yllin për punën e madhe që e ka bërë deri më tani rreth organizimit të kësaj ngjarje. "E përgëzoj klubin së pari që e ka fituar të drejtën për të organizuar 'Final 8' të Kupës së Kosovës dhe për organizimin që e ka bërë dhe për punën e madhe që po e bën në mënyrë që gjithçka të shkojë ashtu siç duhet në këtë ngjarje. Po ashtu, ne si federatë jemi duke i kryer me përpikëri detyrat tona që na takojnë në bazë të udhëzuesit për organizimin e 'Final 8' të Kupës së Kosovës. Uroj që gjithçka të shkoj sipas planit të paraparë dhe që të gjithë adhuruesit e basketbollit të kënaqen me këtë festë basketbolli, e cila do të fillojë të mërkurën dhe do të përfundojë të dielën", ka thënë Dushku.

Ndërkaq kryetari i KB Golden Eagle Ylli, Naim Berisha, ka thënë se klubi i tij i ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura dhe se gjithçka është gati për e fillimin e 'Final 8' të Kupës së Kosovës. "Gjithçka është gati për fillimin e 'Final 8' të Kupës së Kosovës. KB Golden Eagle Ylli i ka kryer të gjitha detyrat që dalin nga udhëzuesi për organizimin e 'Final 8' të Kupës së Kosovës. Kemi bashkëpunim shumë të ngushtë me Policinë, e cila do të jetë e gatshme të na shërbejë në mënyrë që gjithçka të fillojë dhe të mbarojë në mënyrën më të mirë të mundshme. Ne jemi se në bashkëpunim me FBK-në do të jemi të kënaqur që mund t'u ofrojmë adhuruesve të sportit, në këtë rast basketbollit në Therandë, një ngjarje kaq të madhe. Premtojmë se do të dëshmojmë nivel të lartë të organizimit", ka thënë Naim Berisha.



Final 8 i Kupës së Kosovës do të zhvillohet prej 28 shkurtit deri më 4 mars në palestrën "13 Qershori" në Therandë. Të mërkurën në program janë dy ndeshje çerekfinale: Rahoveci-Kerasan Prishtina (17:15) dhe Golden Eagle Ylli-Borea (20:00), ndërsa të enjten dy të tjera, Sigal Prishtina-Kalaja (17:30) dhe Bashkimi-Trepça (19:45). Ndërkaq gjysmëfinalet do të luhen të premten, e para prej orës 17:30, e dyta prej orës 19:00, si dhe finalet në të dyja konkurrencat të dielën prej orës 16:00 (femrat) dhe 19:00 (meshkujt). Ceremonia e hapjes solemne e kësaj ngjarje madhështore për basketbollin e Kosovës do të bëhet të mërkurën ndërmjet dy ndeshjeve çerekfinale, pra në orën 19:15.

## Filloi shitja e biletave për ndeshjen Shqipëri - Norvegji

TIRANË, 27 SHKURT - Kombëtarja e Shqipërisë në futboll do të luajë miqësore ndaj Norvegjisë më 26 mars në "Elbasan Arena" dhe për të gjithë sportdashësit ka nisur shitja e biletave. Federata e Futbollit nëpërmjet një njoftimi zyrtar bën me dije se ka nisur shitja online e biletave në faqen e internetit të federatës, ndërsa ka zbuluar edhe çmimet e tyre nga 300 lekë të reja deri në 6 000 lekë të reja.

## S'ka fitues në ndeshjen Vllaznia - Drenica

GJILAN, 27 SHKURT - Ndeshja e fundit e javës së 20 në Vala Superligën e Kosovës në futboll ndërmjet Vllaznisë dhe Drenicës u mbyll pa fitues dhe pa gola (0-0). Kjo ndeshje ishte paraparë të luhej të hënën, por u shty për një ditë për shkak të reshjeve të borës. Drenica pati mundësi më të shumta shënimi, por nuk arriti ta konkretizojë asnjërin prej rasteve të krijuara, derisa rastet e veta i shpërdoruan edhe futbollistët e Vllaznisë. Pas këtij barazimi, Drenica mbetet në pozitën e tetë, me 30 pikë, derisa Vllaznia në pozitën e fundit me nëntë pikë.



## Ronaldo synon edhe një "Top të Artë"

MADRID, 27 SHKURT - Ylli portugez i Real Madridit, Cristiano Ronaldo, ka fituar pesë herë "Topin e Artë", por synon ta fitoj të paktën edhe një herë. "Unë thashë që kam fituar gjithçka dhe do të isha i lumtur nëse e mbyllja karrierën. Por, sigurisht se kam forcë dhe ambicie për të fituar një tjetër 'Top të Artë'. Kam forcë për të luftuar për të qenë më i miri, pavarësisht se disa thonë të kundërtën. Kam besim, por varet nga fakti se si do të shkojë sezoni apo Botërori", ka thënë Ronaldo.
Pesë "Topa të Artë" ka fituar edhe ylli i Barcelonës, Lionel



# Avdylaj pret shumë suksese në vitin 2018

PRISHTINË, 27 SHKURT - Kampioni i Austrisë dhe Evropës, Hekuran Avdylaj, ka filluar përgatitjet intensive për duelet e tij që e presin në vitin 2018. Ai në një prononcim për agjencinë "ArenaRing" ka thënë se do të aktivizohet maksimalisht që ky vit të jetë i tij. "Pas një pauze që kam pasur për shkak se më lindi djalë, u dash t'i jap pak hapësirë familjes. Por, tani ka dy javë që kam filluar maksimalisht të përgatitem, pasi me menaxherin tim kemi parapa disa ndeshje t'i zhvillojmë këtë vit, kurse e para pritet të jetë në muajin maj, mandej në qershor si dhe gjatë verës. Shpresoj se ky vit do të jetë i imi, andaj do ta jap maksimumin që të arrij vetëm suksese", ka thënë Avdylaj.
Kikboksieri në fjalë është i lindur në kryeqytetin e Austrisë në Vjenë, por është me origjinë nga fshati Sushicë i Burimit. Deri më tani ka zhvilluar më shumë se 40 ndeshje, shumicën prej të cilave i ka fituar.



# Golden State e Houstoni ndaj kreun në Perëndim, lakersat synojnë 'play-off'-in

HOUSTON, 27 SHKURT - Vijon momenti i mirë në kampionat për skuadrën e Lakersit, që fitoi 123-104 ndaj Atlantës në fushën e kësaj të fundit. Një ndeshje e mirë e ekipit kalifornian, që pati epërsi gjatë gjithë kohës, duke e merituar fitoren, që erdhi falë një loje të mirë kolektive (9 lojtarë realizuan mbi 10 pikë, Ingram më i miri me 21 pikë). Lakersi synon një vend në "play-off" në Konferencën e Perëndimit, aty ku dominon dhe kryeson skuadra e Golden States (ndan kreun së bashku me Houstonin). Kampionët e NBA-së fituan 125-111 në fushën e New Yorkut, sukses që erdhi në pjesën e dytë, falë 26 pikëve të Thompsonit, 22 të Durantit dhe 21 të Curryt. Pa probleme fiton edhe Bostoni, që ende ndodhet në vendin e dytë në Lindje. Skuadra e Celticsit fitoi 109-98 ndaj Memphisit, sfidë ku u dallua Irvingu me 25 pikë, lider në fushë.




**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Atlanta - Lakers | 104-123 |
| Boston - Memphis | 109-98 |
| Brooklyn - Chicago | 104-87 |
| New York - Golden State | 111-125 |
| Toronto - Detroit | 123-94 |
| New Orleans - Phoenix | 125-116 |
| Oklahoma - Orlando | 112-105 |
| Dallas - Indiana | 109-103 |
| Utah Jazz - Houston | 85-96 |
| Sacramento - Minnesota | 100-118 |

## SHKURT

### Dënohet Maliqi, mungon ndaj Lirisë

Komisioni Disiplinor i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) e ka dënuar me dy ndeshje mesfushorin e skuadrës së Ferronikelit, Behar Maliqi. Kartoni i kuq që mori në sfidën e javës së 19 ndaj Dritës i ka kushtuar rëndë mesfushorit Maliqi.

### Matthaus: Lewandowski për Bayernin, si Messi për Barçën

Ish-kapiteni i Bayern Munchenit, Lothar Matthaus, e ka vlerësuar shumë të rëndësishëm Robert Lewandowskin në "Allianz Arena". Sulmuesi polak është lidhur me një transferim në Real Madrid, por Matthaus mendon se ai është i pazëvendësueshëm në Bayern. "Lewa bën dallimin. Ai nuk mund të zëvendësohet. Roberti është një figurë e madhe në Bayern si Messi në Barcelonë. Sidoqoftë, kur Messi lëndohet, pamja e lojës katalanase ndryshon komplet. Bayerni nuk e ka këtë problem. Lewa është lojtar kyç, por ekipi nuk është i vendosur për të sikurse për Ronaldon te Reali apo te PSG-ja për Neymarin", ka thënë Matthaus.

### Ancelotti mund të jetë pasardhës i Wengerit

Nëse Arsene Wengeri shkarkohet në fund të edicionit nga detyra e trajnerit në skuadrën e Arsenalit, atëherë në vend të tij pritet të emërohet Carlo Ancelotti. Lajmi është bërë me dije nga "Daily Star". Një emër tjetër që është folur si trajner i mundshëm i Arsenalit është edhe ai i Luis Enriques, i cili e ka drejtuar Barcelonën dhe Romën.

### Buffoni të rikthehet në kombëtare

Portieri italian Gianluigi Buffon është i gatshëm të rikthehet në kombëtaren e Italisë nëse i kërkohet të luajë në miqësoret ndaj Anglisë dhe Argjentinës muajin e ardhshëm. 40-vjeçari i kishte dhënë fund karrierës ndërkombëtare me Italinë në nëntor, pas dështimit që të kualifikohej në Botëror. Mirëpo trajneri aktual i Italisë Luigi Di Biagio ka thënë se nuk ishte e drejtë që Buffoni ta mbyllte karrierën 20-vjeçare me Italinë me dështimin për kualifikim në botëror. "Kam menduar që të shkoj në pushime me familjen, por kur ekipi kombëtar ju kërkon. Duhet të jeni të pranishëm dhe të mos e braktisni", ka thënë Buffoni për "Mediaset". "Nuk kam nevojë të shtoj asgjë në fjalët e Di Biagios përveçse e ndiej si përgjegjësi dhe besnikëri të cilën duhet t'ia jap kombëtares në këtë moment tranzicioni", ka deklaruar Buffoni.

### Fati i Di Francesco lidhet me Ligën e Kampionëve

Trajneri Eusebio Di Francesco rrezikon shkarkimin nga stoli i Romës, nëse skuadra e tij nuk kualifikohet më tutje në Ligën e Kampionëve. "Corriere dello Sport" raporton se në rast të eliminimit nga Shakhtar Donetsk, Di Francesco do të shkarkohet nga detyra e trajnerit. Kujtojmë se ndeshja e parë në Ukrainë përfundoi me rezultat 2-1.



**Autor: GAZMEND MORINA**

## Fjalëkryq

SHUMËKËNDËSHI (gjeom.)
SHTET FEDERAL NË SHBA
RRAFSHNALTË E MADHE NË AZI (pashq.)
I KALTËR, BLU E MBYLLUR / METAL I HOLLUAR
MURG I VETMUAR
BIMË BARISHTORE NJËVJEÇARE QË PËRDORET GJERËSISHT SI USHQIM
REGJISORI AMERIKAN ...... STONE
E LUHATSHME NË QËNDRIME
LUFTËTARJA PALIKUQI
AKTORJA CAHANI
BASHKËT. NË ANËN TJETËR TË DIÇKAJE, PËRTEJ DIÇKAJE
GATESA
OLIVIER MARTINEZ
RADIUM, TON / KAMBANË E VOGËL (sh.shq.)
KAJDET, OJNAT
DY DUKURI QË KANË NDËRMJET TYRE LIDHJE TË DYANSHME / KËNGËTARJA VALBONA
FUTBOLLISTI NË FOTO (shqip.)
MBROJTJE E DIÇKAJE DUKE E LAVDËRUAR A DUKE E PËRLIGJUR
VLERË, DOBI (krah.)
E GDHENDA
TONELATË
ZANORE / AZEM GALICA
I PËSHPËRITA FJALË MAGJIKE / PUSIA
PJESË E SIPËRME KOSTUMIT, ME MËNGË E ME JAKË TË KTHYER
TRUP QIELLOR QË RROTULLOHET RRETH DIELLIT
VEGËL BUJQËSORE
KAPITULL I FUNDIT I NJË VEPRE
NOTË MUZIKORE / GJYMTYRË E TRUPIT
NËNA / PËRJETËSI (turq.)
PREZANTUESE E NJOHUR SHQIPTARE / SHKENCA QË STUDION TË BUKURËN
VEPËR LETRARE E GJATË
PJESË E MUAJIT / BASHKËT.
FUSHËBETEJA / SHKRIMTARI SHKRELI
GAZETË E MADHE QË BOTOHET NË GJERMANI
MJET I THJESHTË PUNE
PA DOBI / BATARE
KAPËRDIJ / BOJAXHI
EDITA SOPJANI / ZANORE
ADRIAN KRASNIQI
BASHKËT. / SHKRONJA XIX
PJESË RROTULLUESE E NJË MAKINE A E NJË APARATI
SPIKERJA ...... MURTEZI - SHALA / SILIC, VOLT
TASH / LASHTËSI
DY BASHKËTINGËLLORE
PATRIOTI PASHKO / VIJOR
MORE, HEJ / E SHKRIRË
KLUB FUTBOLLI NË GREQI / AKTORI KUTCHER (shqip.)
LEZHA / NJË E PANJOHUR NË MATEMATIKË (shq.)
GJELLA E PËRGATITUR VETËM ME ORIZ
SECILA NGA PJESËT QË FORMOJNË NJË TË TËRË / BASHKIM QELIZASH TË NJËLLOJTA
DY BASHKËTINGËLLORE "MESINA"
INTER
ZANORE / PJESË E BRENDSHME E KËMISHËS (shq.)
AFROHET (bised.) / FUTBOLLISTI ZHJEQI
QYTET NË KOSOVË / ZOG I EGËR GRABITQAR
ADEM JASHARI
HENDEK I THELLË E I GJERË, QË ËSHTË HAPUR PËR TË UJITUR
"N" para dy "R" / ILAZ KODRA
PUSULLA / KRYEQYTETI I NJË SHTETI EVROPIAN
KUNDËRSHTAR I BOLSHEVIZMIT RUS
MENDIM / TELEVIZION I YNI MUZIKOR NË RRJETIN KABLLOR
